

## MATERIALE DHE DOKUMENTE

VALTER MEMISHA

**RRETH VEPRËS “ALBANSIKYT GOBOR B SELO MANDRICA”  
(E FOLMJA SHQIPE NË FSHATIN MANDRICË)**

Në vitin 2016, nga Universiteti për ekonomi kombëtare e botërore (Университет за национално и световно стопанство) në Sofje, Bullgari, botohet vepra “Албанският говор в село Мандрица / E folmja shqipe në fshatin Mandricë – Въз основа на изледванията на Димитър Шутерики и Махир Доми / Në bazë të studimeve të Dhimitër Shuteriqit dhe Mahir Domit. По случай 101-ата годишнина от тяхното рождение / Me rastin e 101-vjetorit të lindjes së tyre. / Превод, коментар и допълнения Людмил Станков, Përktimi, komenti dhe plotësimet Ludmill Stankov”.

Vepra është e një lloji të veçantë, sepse ngrihet mbi një material dialektor të vjelë në terren, përgjithësisht, jo nga autori i veprës (Ludmill Stankov), por nga artikujt e botuar në revistën “Studime filologjike” nga studiuesit Dhimitër Shuteriqi dhe Mahir Domi (M. Domi, Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*; Dh S. Shuteriqi, *Fjalorth i të folmes shqipe të fshatit Mandricë, (Bullgari)*; Dh. S. Shuteriqi, *Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica. Studim dhe tekste*)<sup>1</sup>, që përmbajnë lëndë gjuhësore etno-folklorike, mbledhur në fshatin Mandricë në ekspeditat gjuhësore të bëra në vitin 1959 në fshatin Mandricë<sup>2</sup>, apo lëndë të mbledhur edhe nga studiues të tjerë para tyre, në këtë mjedis shqipfolës. Gjithashtu, si

---

<sup>1</sup> M. Domi, Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, SF, 1965, 2; Dh. S. Shuteriqi, *Fjalorth i të folmes shqipe të fshatit Mandricë, (Bullgari)*, SF, 1965, 2; Dh. S. Shuteriqi, *Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica. Studim dhe tekste*, SF, 1965, 2.

<sup>2</sup> Studiuesi Dhimitër Shuteriqi shkruan se “Më 1949, një nxënësi im, ahëre student në Universitetin e Plovdivit, më dërgoi tekstin e një kënge popullore shqipe, të mbledhur në fshatin shqiptar Mandricë të Bullgarisë, nga një mandricar vetë. Teksti ishte shkruar me alfabetin bullgar dhe unë e gjeta ahëre jo të përshtatshëm për botim. Prita rastin të shkoj vetë në Bullgari dhe të vizitoj të vetmin fshat ku ende flitet shqipja në atë vend. Kjo u bë në shtatorin e vitit 1959”. Shih më gjerë artikullin të përkthyer në bullgarisht, “Албанското село в България – Мандрица, Изледване и текстове” (*Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica, studim dhe tekste*), në “E folmja shqipe në fshatin Mandricë / Албанският говор в село Мандрица, София, 2016, f. 6.

do të shihet dhe gjatë paraqitjes së veprës, aty ka lëndë shumë më të gjerë sesa kjo, sepse autori e ka shtrirë spektrin e burimeve të tij. Vepra, për vlerat që mbart shënon ngjarje në studimet tona dialektologjike, por edhe në ato të bullgarishtes.

Siç vërehet nga shënimet në ballinën e botimit dhe që shoqërojnë titullin (Përkthimi, komenti dhe plotësimet Ludmill Stankov)<sup>3</sup>, te ky botim vërehen disa komponente ndërtuese:

a. Lënda në shqipe (që së shumti është e mbledhur nga studiuesit e mësipërm shqiptarë) në këtë punim, përkthimi i saj në bullgarishte, si dhe elementet analizuese, komentuese dhe plotësuese që e ndjekin punimin nga faqja e parë deri tek ajo e fundit e që mbajnë dorën e z. Ludmill Stankov, mishërojnë një punë të kujdesshme, përkthimore, por edhe gjuhësore, të këtij studiuesi.

b. Punimi qëndron i mëvetësishëm si punim monografik, edhe për arsyen, se ai mbart një lëndë gati të plotë për të folmen e Mandricës, me një informacion historik, etnografik, demografik, dialektologjik (me lëndë fonetike, morfologjike, leksikore, frazeologjike etj.), folklorik etj. Kjo lëndë ka vlerë e interes të veçantë. Ajo u ka shërbyer studimeve të ndryshme shqiptare të mëvonshme veçanërisht atyre gjuhësore (Përmendim këtu studimet e J. Gjinarit, Gj. Shkurtaç, por edhe të E. Çabejt, Sh. Demirajt, K. Topallit etj.) dhe tani me këtë botim e zgjeron dukshëm mundësinë e shfrytëzimit të saj, sepse e përkthyer në bullgarishte, bëhet e njohur dhe e shfrytëzueshme dhe për lexuesin shkencor e për studiuesin bullgar e më gjerë.

c. Punimi, siç kemi theksuar më parë, mbart dy prurje të mëdha: autori Stankov ka sjellë në formatin shkencor të një punimi monografik, pra të organizuar e të sistemuar, pasurinë gjuhësore dhe jashtëgjuhësore të lëndës së mbledhur, të përzgjedhur e të kategorizuar profesionalisht nga dy studiuesit shqiptarë (Dh. Shuteriqi dhe M. Domi); por ai ka sjellë edhe lëndë të re të vjelë nga studiues të tjerë bullgarë apo jobullgarë (të pasqyruar në punime të ndryshme në mjedisin shqipfolës të fshatit Mandricë). Llojshmëria dhe cilësia e kësaj lënde në punim është mundësuar edhe nga që autori, me gjuhë amtare bullgarishten, është njohës i mirë i shqipes.

<sup>3</sup> Në vazhdim citimet nga vepra “Албанският говор в село Мандрица / E folmja shqipe në fshatin Mandricë - Въз основа на изледванията на Димитър Шутерика и Махир Доми / Në bazë të studimeve të Dhimitër Shuteriqit dhe Mahir Domit. По случай 101-ата годишнина от тяхното рождение / Me rastin e 101-vjetorit të lindjes së tyre. / Превод, коментар и допълнения Людмил Станков, Пërkthimi, komenti dhe plotësimet Ludmill Stankov”, do të jepen të referuara si Людмил Станков, *Албанският говор в село Мандрица / Ludmill Stankov, E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, София, 2016.

d. Vepra *Албанският говор в село Мандрица / E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, ka sistemuar, plotësuar dhe organizuar shkencërisht, tashmë në formatin e një punimi monografik, gjithë lëndën që kishim më parë në duar, por të shpërndarë dhe të botuar tematikisht në organe të ndryshme nga studiues të ndryshëm.

e. Vepra është tregues i një pune të vështirë, serioze, pasionante, të frytshme e të dobishme shkencërisht, por edhe një prurje me vlera të pazëvendësueshme në fushën e marrëdhënieve të dy popujve tanë, në kohën kur në Ballkan ka filluar një epokë e re dhe kur urat e miqësisë po shtohen gjithnjë e më shumë edhe nga perspektiva evropiane e popujve që jetojnë në gadishull.

\*\*\*

Vepra është strukturuar në disa pjesë, duke shpalosur fusha që rrokin të japin së pari informacion gjuhësor, e më tej një informacion enciklopedik:

I. Veprën e hap një material si *fjalë përcjellëse* për botimin në bullgarisht, i titulluar si vetë vepra, “Албанският говор в село Мандрица” (*E folmja shqipe në fshatin Mandricë*), me një informacion përmbledhës për lëndën e shfrytëzuar për hartimin e punimit, lëndë e mbledhur nga shkrimtari e studiuesi Dh. Shuteriqi dhe gjuhëtari M. Domi e të botuar në Studime filologjike, Tiranë, në vitin 1965. Botimi vjen si përkushtim ndaj dy akademikëve shqiptarë elbasanas, me rastin e 101-vjetorit të lindjes së tyre. Më tej jepet një informacion historik e etnografik për fshatin Mandricë në Bullgari, një informacion për studimet dhe studiuesit që kanë ndërmarrë studime të drejtpërdrejta për këtë të folme apo kanë folur rreth saj (Dh. Shuteriqi, M. Domi, E. Lafe, V. Aleksova, M. Peeva, A. Georgeva etj.), si dhe për punën e studentëve të gjuhës shqipe të Universitetit të Sofjes, Bullgari (dy ekspedita).

Në vazhdim, autori L. Stankov e ka parë të arsyeshme të japë në punim, të përkthyer në bullgarishte gati të plotë, artikullin e Dh. Shuteriqit “*Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica, studim dhe tekste*”, botuar në “Studime filologjike”, 1965/1 (pa tekstet e mbledhura në këtë fshat dhe pa disa konkluzione, të cilat do t’i shohim të rimarra e të organizuara mirë në pjesët vijuese të monografisë). Mendojmë të veçojmë këtu disa pjesë nga ky artikull i përkthyer, me qëllimin që t’i mësojmë informacionit enciklopedik të sjellë (informacion gjeografik, historik, etnografik etj.). Në monografi pohohet se gjeografikisht “Mandrica gjendet në këndin më juglindor të Bullgarisë, tamam në kufirin bullgaro-greko-turk. Është qendër lokaliteti në rrethin e Ivajlovgradit. Fshati është i veçuar në vise kodrinore dhe dushkaja.

Është një a 30 km nga Adrianopoli i Turqisë, të cilin mandricarët e quajnë Qytet, kurse çdo qyteti tjetër i thonë kasaba.”<sup>4</sup>

Në sythin / në fjalën përcjellëse “Албанският говор в село Мандрица” (*E folmja shqipe në fshatin Mandricë*) gjejmë, gjithashtu, një *informacion demografik*, të vështruar historikisht, për kolonitë shqiptare në Turqinë Evropiane, për të ardhur tek informacioni për fshatin Mandricë, Bullgari. Po japim një citim të plotë, ku ndër të tjera thuhet se “Në Turqinë e Evropës, në rrethet e Adrianopolit e të Kërklisesë, kanë qenë 8 koloni shqiptare në fillim të këtij shekulli: Mandrica, me 650 shtëpi, ishte më e madhja e pak e veçuar nga të tjerat. Pastaj vinin: Sulltanqoj, me 300 shtëpi, Ibriktepe (shqip, Qytezë), me 400, Alltëntash, me 150, Pazardere, me 150, Zallëf, me 450, Aballar (themeluar në vitet ‘80 të shekullit të kaluar, nga 60 shtëpi të Zallëfit), me 100 shtëpi, dhe Karaxhakli (themeluar në vitet ‘90 të atij shekulli, nga 16 shtëpi të Zallëfit), me 80 shtëpi. Një lajm i vitit 1926, na mëson se këto fshatra shqiptare ekzistonin akoma ahëre. Në Mandricë na thanë se matanë kufirit, në Turqi janë edhe këto fshatra shqiptare: Zallëfi, me afër 600 shtëpi, Alltëntashi, me afër 100 shtëpi, në lindje të lumit Marica; Ibriktepeja ose Qyteza, me afër 70 shtëpi, në perëndim të lumit. Noli vetë na mëson se, gjatë luftës ballkanike (1912), fshati i tij, Ibriktepe, u pushtua nga bullgarët, pastaj nga turqit e së fundi grekët, të cilët e prishën. Pas luftës greko-turke, më 1923, bashkë me grekët që u dbuan prej Turqie, u dbuan edhe ortodoksët shqiptarë të Ibriktepesë. Këta u vendosën në Greqi, në viset moçalore të Maqedonisë, ku shumica vdiqën nga sëmundjet. Ata që shpëtuan, përfunduan në mizerje në Selanik. Sot, gjithënjë sipas Nolit, Ibriktepeja banohet prej turqish të ardhur nga Maqedonia e Thraka, kurse në Mandricë na thanë se atje flasin akoma shqip.”<sup>5</sup>

Nga artikulli i studiuesit Dh. Shuteriqi, “*Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica, studim dhe tekste*” (që ka zënë vend i përkthyer në monografinë e L. Stankovit) veçojmë dhe informacionin etno-gjuhësor. Aty theksohet se “Mandrica është përmbledhur pranë lumenjve të vegjël Akçehisar dhe Këzëll Delidere. Ka rreth 200 shtëpi, pra është shumë më e vogël nga ç’ishte në fillim të këtij shekulli. Të gjithë flasin *shqip*, edhe bullgarët që banojnë aty. Takuam një ushtarak bullgar, i cili kishte diçka më shumë se një mot në Mandricë dhe që merrte vesh gjuhën e fshatit, kurse fëmijët e tij e flitnin shqipen si mandricarë të vërtetë. Gjithë shqiptarët, me ndonjë përjashtim të rrallë, flasin edhe bullgarisht.”<sup>6</sup>

<sup>4</sup> Людмил Станков, *Албанският говор в село Мандрица* / Ludmill Stankov, *E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, София, 2016, f. 6-7.

<sup>5</sup> *Po aty*, f. 7-8.

<sup>6</sup> *Po aty*, f. 7.

Vepra, kuptohet që informacionin kryesor e ka nga fusha e gjuhësisë. L. Stankov jep me të drejtë mendimin e studiuesve shqiptarë për ndikimin e bullgarishtes në të folmen e fshatit Mandricë. Ky komponent do të shpërfaqet në mënyrë të vazhdueshme në punimin monografik, duke i parë pasojat e tij në të gjitha nënsistemet apo në dukuri e procese të ndryshme gjuhësore të kësaj të folmeje. Autori i përgatitjes së punimit përkthen: “Fenomen i veçantë për të folmen shqipe të Mandricës, është ndikimi i thellë bullgar në fonetikë, në trajtat morfologjike e në sintaksë. Ky ndikim është i madh edhe në fjalor dhe sa vjen e shtohet, ndërsa ndikimi i mëparshëm turk, që është gjithashtu i madh, apo ndikimi grek, që është i kufizuar, tani kanë filluar të humbin teren. Si shpjegohet që, brenda më pak se dy shekujsh, - nëqoftëse pranojmë tezën e një origjine nga shek. XVIII të Mandricës, - gjuha e fshatit pësoi një ndikim aq të thellë bullgar, kurse gati 150 vjet fshati ishte nën Turqinë dhe as 50 vjet nën Bullgarinë? Mandrica gjendet në një rreth thuajse krejt bullgar. Mandricarët janë martuar vazhdimisht me vajza nga fshatrat bullgare fqinjë. Sipas gojëdhënës, kjo ka ngjarë që me themelimin e fshatit. Martesa me grekë nuk mbahen mend të jenë bërë, kurse me turqit krushqia ishte e prerë, për shkak të fesë. Gratë bullgare të martuara në Mandricë, këtu mësonin e flisnin shqip, sikundër dhe burrat e tyre mësonin e flisnin bullgarisht. Ne njohëm dy- tri gra bullgare që ishin martuar në Mandricë dhe që flisnin shqip. Shqipen, domosdo, bullgarët e kanë folur dhe e flasin nën ndikimin e bullgarishtes. Ato flasin shqip, po edhe mendojnë bullgarçe. Kështu shpjegohet ndikimi i shpejtë e i thellë i bullgarishtes mbi të folmen e Mandricës. Ky ndikim ka vajtur duke u theksuar, veçanërisht që nga viti 1912, kur u vendos administrata dhe shkolla bullgare, kur duhet të jetë vendosur edhe kisha bullgare, megjithëse mbishkrimet greke të kishës së Shën Mitrit, bullgarisht u bënë vetëm më 1925, me sa na thanë, kurse mbishkrimet greke të kishës së Shën Nedelës nuk u prekën. Le të vëmë re se, pranë trajtave të ndikuara nga bullgarishtja, si fjala vjen *ze*, *sa*, gjejmë edhe trajtat e pandikuara *dhe*, *tha*. Kjo tregon se ndikimi bullgar, sado i thellë, nuk ka mundur të bëhet i plotë edhe në raste të tilla, se në Mandricë, gjer më sot, shqipja nga më se një anë i ka shpëtuar ndikimit të huaj.”<sup>7</sup>

Si jemi shprehur, për përgatitjen e monografisë “Албанският говор в село Мандрица” (*E folmja shqipe në fshatin Mandricë*) janë shfrytëzuar disa burime, por burimet bazë e më të rëndësishme, gati të shfrytëzuara plotësisht, janë artikujt e M. Domit dhe Dh. Shuteriqit, botuar në vitin 1965 në faqet e revistës shkencore “Studime filologjike” dhe ndër këta artikuj veçohet punimi *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*. Ky artikull i ka shërbyer studiuesit L. Stankov për të hartuar pjesët e punimit që lidhen

<sup>7</sup> *Po aty*, f. 18.

me dukuritë e proceset fonetike e gramatikore. Studiuesit shqiptarë të sipërpërmendur, të mbështetur në materiale gjuhësore të mbledhura në terren, në Mandricë, në këtë artikull shtrojnë pyetjen dhe me të drejtë japin dhe një përgjigje tërësisht të arsyetuar e të justifikuar: “A na jep gjuha elemente të mjafta për të hedhur dritë mbi çështjen se nga ç’treve e Shqipërisë e kur u shkulën themeluesit e këtij fshati? Për të thënë një fjalë pak a shumë të sigurtë, do të duhej një material më i plotë, e t’i shtrohej ai një krahasimi sistematik me materialin e të folmeve të ndryshme të Shqipërisë. Tani për tani mund të bëhet ndonjë konstatim e të hidhet ndonjë hipotezë, hipotezë pune më tepër, që mbetet për t’u kontrolluar e për t’u vërtetuar me kërkime të mëtejshme.”<sup>8</sup>

Më tej këta studiues *me fakte gjuhësore* argumentojnë hipotezën që banorët e këtij fshati në Bullgari vijnë nga territoret juglindore të Shqipërisë së sotme. Ata shkruajnë se “Mjaft tipare e fenomene të së folmes të shpjen në veçori të zonës së Korçës e pikërisht të Devollit (parafjalët *ndë, ndër* përfunduar në *dë e dër*, trajtat e shumës në të tanishmen e dëftores e të lidhores pa zanoren tematike *-i*, në Devoll: *ngasëm, ngasën*, në Mandricë: *hapmë, mbjellmë*, gjasësisht nga *hapëmë, mbjellëmë*; përdorimi i dendur i shumës në emrave në *-ra* dhe i aoristit në *-ta*, disa trajta të përemrit pronor shumë, në Devoll: *gjishtrinjt tem, duart time, duart tënde*, në Mandricë: *timet vëllazëra, tëndet roba*; shumica e trajtave të së pakryerës të foljeve *kam* dhe *jam*: në Devoll: *kisha, kisha, kish, kishim dhe kishmë, kishit, kishin* dhe *kishnë; isha, ishim, a ishnë*, në Mandricë: *kisha, kisha, kish, kishmë, kishitë, kishnë*) e ndonjë tjetër. Duhet shtuar se tiparet e elementet kryesore arkaike të së folmes së Mandricës kanë qenë të gjalla gjer tani vonë në një pjesë të Devollit, në Dardhë, Sinicë, Qytezë, e kemi fjalën për konservimin e grupeve të bashkëtingëlloreve *kl, gl, lk*, për ruajtjen pjesërisht të diftongut *uo*. Mund të shtohet se fenomeni i daljes së një *v* epentike në Mandricë pas *u-së*, në ndonjë rast të rrallë pas *y-së* (*gruvo, gruva, gruvë, pruvë, u zgjuvejt, dyver*) shihet edhe në Dardhë, ku janë ndjerë kryesisht të mosha e vjetër: *kruva* (me një *v* dybuzore), *gruva* etj.”<sup>9</sup>

Këtë argumentim e pranon dhe pohon në mënyrë të vazhdueshme edhe L. Stankov, gjatë gjithë trajtesave për nënsistemet e ndryshme të së folmes shqipe në fshatin Mandricë. Por në monografi jepen edhe elemente nga gegërishtja (shpesh si rimarrje nga punimet në shqipe, botuar në revistën Studime filologjike). Edhe këtu Stankov është në linjën e dy akademikëve shqiptarë, të cilët theksojnë se “Si është thënë në studimin Dh. Shuteriqi, *Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica* (Studime filologjike, 1965, nr. 1)

<sup>8</sup> M. Domi, Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, SF, 1965, 2, f. 117.

<sup>9</sup> *Po aty*, f. 117-118.

mandricarët mbahen të ardhur nga Vithkuqi e nga anët e Korçës, ndërsa fshatrat e afërta shqiptare përtej kufirit si Ibrik Tepeja a Qyteza e Fan Nolit, nga Kolonja, Dardha, Sinica s'janë larg nga Vithkuqi, e ngjitur me Kolonjën. Tiparet e pjesëshme arkaike janë kështu konservacione të një zone malore të ruajtura edhe në Shqipëri gjer vonë, ndërsa gjuha në tërësinë e saj nuk të jep një fazë aqë arkaike të shqipes. Prandaj shpërngulja është e këtyre shekujve të fundit, gjë që përforcon përfundimet e arritura në studimin e sipërpërmendur... Ndonjë element i rrallë, që të kujton gegërishten (raste të diftongut *ue* ose të monoftongizimit në *u*, forma si *çar*, *nashti*, *s'un*) mund të vijë nga fakti se në popullsinë e këtij fshati janë të përzier edhe të ardhur nga Shqipëria e Mesme. Studjuesi bullgar Jaranov thotë se që nga shekujt XV-XVI gjer në shekullin e XIX ka pasë shpërngulje për në Maqedoninë lindore, Traki, Mizi, jo vetëm nga krahina e Korçës, por edhe nga ato të Elbasanit e Dibrës.”<sup>10</sup>

\*\*\*

Në vazhdimësi po ndalemi në pasuritë e veçoritë kryesisht gjuhësore që shpërfaq *e folmja e Mandricës*, e ardhur në bullgarishte përmes përkthimit të saktë nga L. Stankov, në veprën “Албанският говор в село Мандрица” (*E folmja shqipe në fshatin Mandricë*).

II. Në kreun *Fonetika*, 12 faqe, L. Stankov ka sjellë përmbledhtas tipare, dukuri dhe procese fonetike nga të kësaj të folmeje<sup>11</sup>. E rëndësishme është të theksojmë se dukuritë fonetike, morfologjike etj. i jep siç gjallojnë (apo gjallonin kur janë mbledhur) në të folme, i përqsas jo rrallë me formën librore (книжовна форма) ose me shqipen standarde dhe mandej, në funksion të botimit të veprës, çdonjëren e jep me barasvlerësin *fjalë* apo *fjalëformë* në bullgarishte.

Gjithashtu, në punimin monografik “Албанският говор в село Мандрица / E folmja shqipe në fshatin Mandricë - Въз основа на изледванията на Димитър Шутерики и Махир Доми / Në bazë të studimeve të Dhimitër Shuteriqit dhe Mahir Domit”, gjen përqsasje dukurish apo procesesh fonetike me punime të studiuesve të tjerë bullgarë (N. V. Kotova, Materiali po albanskoj dialektologji. Albanskie govori Ukraini, në Uçenie zapiski Instituta Slavjanovedenja, Tom XIII, 1956), apo përqsasje me të folme toske (me çamërishten, labërishten), apo siç do shihet dhe në kreun për veçoritë morfologjike të së folmes, edhe përqsasje me dukuri a procese fonetike në gegërishte (me të folmen e Ulqinit, të Durrësit etj.) dhe me të

<sup>10</sup> *Po aty*, f. 118.

<sup>11</sup> Për gjithë referimet dhe interpretimet nga fusha e *fonetikës dhe jo vetëm*, shih më gjerë punimin monografik Людмил Станков, *Албанският говор в село Мандрица / Ludmill Stankov, E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, Софија, 2016, f. 20-31.

folme arbëreshe të Italisë (p.sh., me të folmen e fshatit Montecilfone) etj. Duhet të theksojmë edhe një herë se këto përjasje janë marrë nga punimi *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, i autorëve M. Domi, Dh. Shuteriqi dhe botuar në SF, 1965, 2. Pra edhe për fonetikën, punimi monografik është mbështetur tërësisht në materialin e dy studiuesve shqiptarë, por ka meritën se lënda, jo vetëm ka ardhur e përkthyer saktë në bullgarishte, por është konceptuar e gjitha si pjesë e një punimi të plotë monografik.

A. Nga *sistemi zanor* veçojmë dukuritë dhe proceset e mëposhtme<sup>12</sup>:

a. Variantet e diftongjeve “uo”<sup>13</sup>: përgjithësisht ka dhënë si në toskërishte **ua**: grua (por edhe *gruo*, *gruva*, *gruvë*) etj. Mjaft dendur është ruajtur edhe **uo** (*duoll* / *doli*, *mbuoll* / *mbolli*, *të huoj* / *të huaj*) etj. me ndonjë përjashtim të rrallë **uo** del si në gegërishte **ue** (*u shuetnë kandilet*) ose **u** (*prru* / *prrua*) etj. Ka dhe raste kur **o** nuk del e diftonguar, edhe pse kushtet fonetike janë (*pagoj*, *pagojmë*, *mos pagoj* për *paguaj*, *paguajmë*, *mos paguaj*; *neve domë* për *ne duam* etj.).

b. Diftongu **ye** ruhet si në toskërishte pa u monoftonguar: *unë ngjyen*, *ngjyesh*, *ngjyen*, *ngjyjemë* etj. Ky diftong te folja *pyet* kthehet në jo: *pjet* (*pyet*), *pjosnë* (*pyesin*). Në një rast **ye** e kthen **y** në **u** (-**ue**) dhe midis dy zanoreve futet v: *kruven* (*kryen*);

c. Diftongu **ie** shqiptohet **je**: *djella* (*dielli*). Në disa raste **ie** shqiptohet reduktohet në **e**: *tetzet* (*tetëdhjet*), *statzet* (*shtatëdhjet*).

L. Stankov citon përsëri nga autorët Domi e Shuteriqi se “Në këtë mënyrë, në trajtimin e diftongjeve, e folmja e Mandricës ndryshon nga të folmet shqipe të Ukrainës, ku po ashtu si përgjithësisht në gegërishten e sotme, e në disa kategori fjalësh në fshatin arbëresh Montecilfone të Molises, Itali, ato janë monoftonguar në **u**, **y**, **i**.”<sup>14</sup>

d. Në monografi, mbështetur në lëndën e bollshme të botuar në revistën “Studime filologjike”, zë vend të rëndësishëm shqiptimi i zanores **ë** në pozicione të ndryshme në fjalë dhe ndaj theksit. Shembujt e sjellë këtu, edhe kur referohen te shqipja (jo tek e folmja e Mandricës) ruajnë formën e sjellë

<sup>12</sup> Në punimin “Албанският говор в село Мандрица” (*E folmja shqipe në fshatin Mandricë*), dukuritë e trajtuara ndjekin ecurinë, llojin dhe sasinë e elementeve paradigmatiche që jepen në artikullin *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, të M. Domi, Dh. Shuteriqi, botuar në SF, 1965, 2.

<sup>13</sup> Po sjellim këtu informacionin shkencor (konceptin për diftongun) siç është në vepër, sepse në shqipen standarde nuk pranohet diftongu te grupet **uo**, **ue**, **ie**, **ye**, sepse në fjalët e leksikut vendës të shqipes, zanoret **u**, **i** dhe **y** janë të theksuara, kështu që në rastet që interpretohen ne kemi grup zanoresh.

<sup>14</sup> Людмил Станков, *Албанският говор в село Мандрица* / Ludmill Stankov, *E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, София, 2016, f. 22.

nga Domi e Shuteriqi dhe së shumti nuk përqasen me formën e shqipes standarde.

Vend të veçantë në vepër i kushtohet **ë**-s fundore të emrave të shquar në numrin njëjës në rasën kallëzore e dhanore: *derënë, gjënë; mëmësë, mullisë* etj.. Kjo dukuri shfaqet edhe kur emra të gjinisë mashkullore dhe femërore mbarojnë me **r**: *zemërë, qiqërë, sekërë, gjarpërë, dimërë, emërë*. Edhe në këtë syth, të gjithë shembujt janë shoqëruar me barasvlerësin në bullgarishte. Zanozja **ë** fundore del dhe në sistemin foljor: *japmë, japnë, shkrojmë, shkojnë, rojmë, rojnë, rahëmë, rahinë; duollmë, duollnë, dilnimë, dilninë...; ritenë, gëzohenë; gëzohenishenë, gëzohenishtë...; viezorë (vjedhurë), zemborë (dhëmburë)*.

Gjithashtu, është paraqitur si dukuri e veçantë kthimi i **ë**-s në **i**: *gjimoj < gjëmoj, lishoj < lëshoj*; kalimi në rrokje paratheksore, si rezultat i asimilimit regresiv, i **ë**-s në **u**: *këtu > kutu, këpucë > kupucë, sëmundë > sumundë, mëndafsh > mundafsh*.

Aty pranohet se nën ndikimin e bullgarishtes<sup>15</sup>, **ë**-ja e patheksuar fundore kthehet në **e**: *më > me, shumë > shume, të sërësësh të sërësesh* etj. Kurse **ë**-ja e theksuar kthehet në **i**: *gji < gjë, tindija < tëndeja* etj.

e. Në të folmen e Mandricës **e**-ja e theksuar para bashkëtingëlloreve hundore shqiptohet **ë**: *qën < qen, vënt < vend* etj.

f. Zanozja **y** ka disa transformime: **y > u**: *du < dy, frunish < frynte, qutet < qytet* etj. *kush < qysh* etj.; **y > ju**: *bërrjumë < brymë, djullë < dyllë, tju < ty* etj.; **y > i**: *mbill < mbyll, hikan < hykan* etj.; rrallë **y > jy**: *sindjuk / sjuduk < sënduk; djyljyme < dylym, djymbëzjetë < dymbëdhjetë, kji < ky* etj. Për shumë nga këto ndërrime fonetike autori nënvizon se janë dukuri të njohura në çamërishte, labërishte dhe në disa në folme të gegërishtes qendrore<sup>16</sup>.

g. Zanozja paratheksore **o** ka dhënë **u**: *dullap < dollap, bukor < i, e bukur* etj.

h. Gjithashtu ndodh që zanoret paratheksore kthehen në **ë**: *ngërkojnë < ngarkojnë, pëstaj < pastaj, prëftaska < proftaska, pës < posi, këllon < kullon, sëllmë < sillmë* etj.

i. Vërehen edhe raste të tjera të ndërrimit të zanoreve **o > a**: *mari < mori; e > o*: *ngro < ngre; ov > u*: *guatënë < gotatënë*.

<sup>15</sup> M. Domi dhe Dh. Shuteriqi thonë nën ndikimin e sllavishtes: “**Ë** e patheksuar, fundore ose jo, herë-herë, ndofta për efekt të ndikimit të sllavishtes, ndihet e...” *Shih* M. Domi, Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, SF, 1965, 2, f. 105.

<sup>16</sup> Людмил Станков, *Албанският говор в село Мандрица* / Ludmill Stankov, *E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, Софија, 2016, f. 24

j. Në këtë të folme, ashtu si në çamërishte, nuk ndodh krasi i trajtës së shkurtër të përemrit vetor në rasën kallëzore *e* me pjesëzën *të* të lidhores, po vetëm elizioni i *ë*-së (*t'e* < *të* + *e*): *t'e mar* < *ta marr*, *t'e hamë* < *ta hamë* etj.

B. Vend të rëndësishëm në veprën / *Албанският говор в село Мандруца* / *E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, ka zënë dhe shqiptimi i bashkëtingëlloreve:

a. Nën ndikimin e bullgarishtes, interdentalet (ndërdhëmboret) **dh** e **th** në këtë të folme, ndryshe nga të folmet shqipe të Ukrainës, janë kthyer në **z** e **s**. Bashkëtingëlloerja **dh** është kthyer dhe në **d**.

- **dh** > **z**: *dhëndër* - *zëndër*, *dhemb* - *zëmb*, *i madh* - *mazi*, *udhë* - *uzë* etj.

- **th** > **s**: *i gjithë* - *gjisë*, *i thatë* - *satë*, *thikë* - *sikë*, *thotë* - *sotë*, *të thuash* - *të sosh* etj.

- **dh** > **d** apo **z**: *dardhë* - *darzë*, *erdha* - *erda* / *erz*, *i bardhë* - *bardë* / *barzë* etj.

Autori i monografisë L. Stankov, gjithnjë duke përkthyer lëndën gjuhësore të dy studiuesve shqiptarë, ndalet në mënyrë të imtë dhe në dukuri e procese të tjera fonetike në sistemin bashkëtingëlloreve që karakterizojnë këtë të folme.

b. Grupet **gl** e **kl** të kësaj të folmeje, ashtu si në të folmet shqipe të Ukrainës dhe në çamërishte (Greqi), ruhen në mjaft fjalë: *gluhë* / *glufë* (*gjuhë*), *glisht* (*gisht*), *glu* (*gju*), *klisë* (*kishë*), *klumësht* (*qumësht*), *kle* / *klekam* / *kleka* (*qe*, *qenkam*, *qenka*) etj.

c. Grupi **lj**, i cili në shqipe jep **j**, në këtë të folme është kthyer në **l**: *bilë* / *bilëra* (*bijë*, *bija*), *fëmilë* (*fëmijë*), *val* (*vaj*) etj.

d. Hasen grupet **lk**, **lg**, **lq**: *ulk* (*ujk*), *dilgon* (*dëgjon*), *helq* (*heq*).

e. Bashkëtingëlloerja hundore **nj**, diku nën ndikimin e bullgarishtes del **n** (*qirintë* - *qirinjtë*, *ni* - *një*, *neri* - *njeri* etj.), diku **n'j** (**n** dhe **j**) (*shkeln'ja* - *shkelja*, *n'joh* - *njoh*) etj.

f. Si në toskërishte, shqiptohen me **r** fjalë që në gegërisht shqiptohen me **rr**: *bera* (*berra*), *zjar*, *të marë*, *merni*, *nxjer*.

g. Bashkëtingëlloerja **ll** në disa raste ka dhënë **l**: *akul* (*akull*), *yl* (*yll*) etj.

h. Bashkëtingëlloerja **f** kthehet në **h**: *hustan* (*fustan*), *hushë* (*fushë*), *hurrë* (*furrë*) etj.

i. Grupi **nd** ka përfunduar në **d** (*i erdëka* *dër mënt*) ose në **n**.

j. Ndodh shurdhimi pozicional dhe kombinator i bashkëtingëlloreve: *ardhka* > *arthka*, *lidh* > *lis* (*lith*) etj.

l. Autori veçon dhe raste sinkope (*bati* < *bagëti*) e apokope (*si* < *përsi*, *përsëri*).

III. Kreu "*Morfologjia*" me 123 faqe (32-154), zë pjesën dërrmuese të punimit. L. Stankov rimerr nënvizimin e prof. Domit dhe Shuteriqit se

“Morfologjia e shqipes së Mandricës karakterizohet nga ruajtja e disa trajtave të lashta, sidomos te foljet, po ashtu edhe nga fakte gjuhësore që janë rezultat i ndikimit të bullgarishtes”<sup>17</sup>. Monografia mëton të japë pamje të morfologjisë eptimore të së folmes shqipe të Mandricës. Duke u mbështetur në klasifikime, grupime e kategori leksiko-gramatikore të njohura autori kalon nga deduksioni në induksion, dhe e kundërta, duke bërë ilustrime të shumta e gjithnjë me barasvlerësin e çdo njësie (fjalëforme) në bullgarishte. Në vazhdim po ndalemi në vendin që zënë pjesët e ligjëratës në vepër:

A. Emri a. Punimi ndalet fillimisht te kategoria gramatikore *e gjinisë*, duke rimarrë mendimin e dy studiuesve shqiptarë se në këtë të folme, krahasuar me shqipen, ka ndryshime të gjinisë së shumë emrave, ndodhur nën ndikimin e bullgarishtes. Në vijim jepen dy grupime njësisht: me emra të gjinisë mashkullore dhe me emra të gjinisë femërore. Te njësitë e përfshira tek të dy grupimet ka ndonjë pasaktësi apo paqartësi, që nuk motivohen edhe nga ndonjë lëvizje automatike të lëndës gjatë formatimit të saj kompjuterik. Kështu:

a. 1. Te grupi i emrave të gjinisë mashkullore (м. род), përveç emrave *diell*, *-i* dhe *baba*, *-i* janë përfshirë edhe emrat (jofrymorë) që sipas mbaresave i përkasin gjinisë femërore: *pleh/ë*, *-a* (*plehu*); *shi*, *-ja* (*shiu*); *krah/ë*, *-a* (*krahu*); *ze*, *-ja* (*dheu*); *hi*, *-ja* (*hiri*); *lum/ë*, *-a* (*lumi*); *klumësht*, *-a* (*qumështi*); *ze*, *-ja* (*zëri*). Mendojmë se për të bërë grupimin autori është mbështetur në fjalëformat e këtyre emrave në shqipen e sotme, të cilat janë dhënë edhe nga Domi e Shuteriqi dhe jo në lëndën konkrete që ofron e folmja e Mandricës.

a.2. Në krah të djathtë të këtij grupi, me markimin *gjini femërore* (ж. род) jepet vetëm fjala *diell* në dy variante fonetike të gjinisë femërore: *djell*, *-a*; *diel/ë*, *-a*. Kurse në vazhdim jepen të njëjtat fjalëforma të grupit të gjinisë mashkullore, me një mbartje paralele: *pleh*, *-u*; *shi*, *-u*; *krah*, *-u*; *dhe*, *-u*; *lum/ë*, *-i*; *qumësht*, *-i*; *zë*, *-ri*.

a.3. Në gjininë asnjëse sjell *glishtë*, *-të* (*gisht*, *-i*).

a.4. Në punim nënvizohet se shumica e emrave të lëndës kanë kaluar nga gjinia asnjëse në gjininë femërore: *djas/ë*, *-a* (*djathë*, *-i*); *dull/ë*, *-a* (*dyll*, *-i*); *uj/ë*, *-a* (*uj/ë*, *-i*); *gjalp/ë*, *-a* (*gjalp/ë*, *-i*); *dris/ë*, *-a* (*drith/ë*, *-i*); *ball/ë*, *-a* (*ball/ë*, *-i*); *mjalt/ë*, *-a* (*mjalt/ë*, *-i*).

a.5. Këtu autori ka futur dhe rasën kallëzore të disa emrave të gjinisë mashkullore që e ndërtojnë fjalëformën pa zanore për lehtësi shqiptimi: *emërnë*, *kalnë*, *tjufeknë*, *zjarnë* etj. Sipas referimit te punimi i Domit dhe Shuteriqit, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, nënvizohet se

<sup>17</sup> Людмил Станков, *Албанският говор в село Мандрица* / Ludmill Stankov, *E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, Софија, 2016, f. 32.

shumë rrallë mbaresa mund të ketë **i** ose **u** anaptike: **-inë**, **-unë**: *vendinë*, *askerllëkunë*.

b. Informacioni i dytë morfologjik vjen për formimin e **numrit shumës të emrave**.

b.1. Me mbaresën **-a** e formojnë shumësin emra të gjinisë femërore, si: *kupë – kupa; opingë – opinga; kopsë – kopsa* etj. Këtu janë dhe disa emra që në shqipen e sotme e formojnë shumësin si njëjës: *lugë – luga; macë – maca; ditë – dita* etj. E formojnë shumësin me **-a** dhe disa emra të gjinisë mashkullore, si: *xham – xhama, gur – gura* etj.

b.2. Mjaft dendur del shumësi me **-ra**: *baltë - baltëra; bilë - bilëra; hushë (fushë) - hushëra; lumë - lumëra; djado - djadora* etj.

b.3. Shumësi i emrave të gjinisë mashkullore formohet dhe me mbaresa të tjera, si me **-e**: *heqim – heqime, yl – yle* etj.; me mbaresën **-nj**: *sua – sonj; glu – glunja*; me mbaresën **-n**: *qiri - qirintë; komshi – komshintë* etj. Gjithashtu, *krushk – krushkërin, nun – nënërin*.

b.4. Jepen si përjashtime: *kal – kvol / kuol; vëlla – vëllazëra*.

c. Nga faqja 35-40, duke mos u ndjekur ecurinë në artikullin e Domit dhe Shuteriqit, në punimin e L. Stankovit, përmes shembujve me fjali apo me ndërtime togfjalësha (këta të shkëputur nga thënie të plota) jepet dukuria e **shquarësisë** së emrave të përgjithshëm në numrin njëjës e shumës, në gjininë mashkullore e femërore (dhe në rasat emërore e kallëzore për numrin njëjës dhe emërore, dhanore e kallëzore për shumësin. Ky syth del si punë vetjake e studiuesit bullgar.

Po japim disa shembuj (që përsëri janë përkthyer në bullgarishte):

c.1. Rasa emërore, njëjës, gjinia mashkullore e femërore: *Zëndëri zënka t'i anastisë-hi ëndërën priftit. Zbora ishte timja sumurluk, djella ishte shpirt.*

c.2. Rasa kallëzore, njëjës, gjinia mashkullore e femërore: *Hipi kalnë Dimçua, vëri nahernë dë brezi, vëri tufjeknë dë krahë... Kur e veshi Maraflua këpucën, u qepka nga këmba.*

c.3. Rasa emërore, shumës, gjinia mashkullore e femërore: *Turqetë ndejtan për të hanë bukë.*

Këtu gabimisht është dhënë si formë e rasës emërore (në funksion kryefjale) dhe ndonjë përdorim i rasës kallëzore, madje është dhënë si emër një mbiemër i paravendosur: *Pa mbruji ze poqi ngroftatë kulaçe (Pa mbruji dhe poqi kulaçet e ngrohta)*

c.4. Rasa dhanore, shumës: *Pa i sotë Risanua baterave.*

c.5. Rasa kallëzore, shumës, gjinia mashkullore e femërore: *U ngrit Mitja pa vate, nuk i gjet heqimetë. Pa i panë vrrarat bota.*

Këtu jepet dhe një syth për trajtën e shquar të emrave të përveçëm të gjinisë mashkullore dhe femërore, në rasën emërore: *Zbriti nga kali Dimçua. U mbet Risanua pa mëmë, pa tate.*

Në vijim L. Stankov, duke cituar dhe prof. Emil Lafe, ndalet te origjina e diftongut (togut zanor) **ua**, që e ka burimin te zbërthimi i një ó-je në rrokje të mbyllur në toskërishte (në gegërishte **ue**): *fton - ftue, ftua*.

d. Në punimin monografik *Албанският говор в село Мандрица / E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, flitet shkurt edhe për formën fonetike të ditëve të javës, të cilat shkruhen pa nyjën e përparme: *hëna, mara, mërkura, tëntja, prëmtja, shtuna, djela*.

e. Gjithashtu, në punim (ashtu si dhe në artikullin e Domit dhe Shuteriqit), për emrin jepet dhe një informacion shumë i shkurtër për fjalëformimin.

e.1. Formime me prapashtesat **-zë, -kë, -ica**: *djemëza, copkë/-a; djellkë/-a* etj.

e.2. Formime me prapashtesën turke **-lik**: *sumurlik, mikërluk (miqësi)* etj.

**B. Mbiemri** ka zënë fare pak vend në monografi. Mbiemri në këtë të folme del i paravendosur (si në bullgarishte) dhe pa nyjë të përparme: *mirë çupë, barza rroba, bukorë shtëpi, ndë vjetra fshat, maze shtëpi, ni kuqe mollë* etj. Mbiemri e formon shkallën krahasore me pjesëzën *me* (më): *bukorë - me bukorë (më i/e bukur)*; kurse shkalla sipërore formohet me pjesëzën bullgare *nai / naj*: *Aju ishte naj togli (Ai ishte më i vogli)*.

**C. Numërori** zë një vend më të gjerë në monografi. Aty jepet një pasqyrë e hollësishme e numërorëve themelorë.

a. Jepen numërorët e thjeshtë nga një te dhjeta: *ni, du / dju, tri, katër, pesë, g'jashtë, shtatë, tetë, nëntë, zjetë*.

b. Jepen numërorët e përngjitur nga *njëmbëdhjetë* te *njëzet*, duke dhënë përkrah tek - tuk edhe ndonjë formë të të folurit gojor (nga thjeshtligjërimi) në Shqipëri: *nimbëzet, djumbëzet, trimbëzjet, katrëmet, pesëmbëzjetë, gjashtëmet* (këtu gabimisht është pranëvendosur forma *gjazhdhjet*, që është shqiptimi joletrar në Shqipëri i numërorit *gjashtëdhjetë*).

c. Jepen shumëfishat e dhjetës, si *trizet, pezjetë, nëntëzjetë* etj.; qindëshet: *një kint, dju kint*, mijëshet: *ni mil*.

d. Jepen gjithashtu disa shprehje numerike: *njizetë ni (21), niste dju (22), trizjet nëntë (39)* etj.

e. Jepen shumë shkurt numërorët rreshtorë: *treta kushërirë, shtatëmetë senë*.

**D.** Një vend të veçantë në punimin monografik *Албанският говор в село Мандрица / E folmja shqipe në fshatin Mandricë* zënë dhe **përemrat**.

1. Me të drejtë L. Stankov i ka dhënë vend të veçantë **përemrit vetor**. Nëse te punimi i Domit dhe Shuteriqit, për këtë përemër kemi vetëm dy rreshta ("Te përemrat vetorë për vetën e parë njëjës përdoret më shumë trajta

un se unë; në vetën e dytë *tinë* pranë ti, në rasat e zhdrejta *tju për ty*)<sup>18</sup>, te monografia *Албанският говор в село Мандрица / E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, jepen në 11 faqe pasqyra të plota të lakimit të përemrit në të tri vetat, në të dy numrat dhe vetën e tretë në të dy gjinitë. Përmendim këtu forma dalluese për të folmen, si *ai, aj,aju, ay* në rasën emërore dhe formën / trajtën e shkurtër *\*hi* në rasën dhanore; *aju, aji* (për *ajo*) në rasën emërore dhe *asajt, \*hi* në rasën dhanore; *ata* dhe *ato* në rasën emërore, si *dhe i, him, atjurmet (atyre u)* në rasën dhanore etj.

Në vijim, në rreth 6 faqe jepen shembuj të shumtë (që kanë interes studimor) të përdorimeve të përemrave vetorë. Veçojmë: *Tatja më la vetëzë. Kërpinë e mbjellka, e prashitka, e qitka, e vëka dë ujë, e menitka, e mbëshjtjellka, e tjerrka, e juvejka, e bitiska. Ton(ë) Maro e hëngrënë karkanxollet. Mëmo, të më japësh ze kur ikën, o t'vjen të të mar. E mer mbreti këzannë, e nxjer jashtë dë bunari* etj. Në punim jepen 35 (25 + 10) shembuj të përemrave vetorë, duke spikatur me të zeza trajtat e shkurtra, sipas Maria Pjejevës, 2016.

2. Ndhimesë vetjake e L. Stankovit është dhe përdallimi në këtë të folme edhe i *përemrit vetvetor* në formën e shkurtër si (си), një ndikim i drejtpërdrejtë nga bullgarishtja (me formën e plotë *себе си*): *Tatja kur vate dë kurbet, më suall ni kuqe moll, kuqe-si moll argjentë. Mere-si, mëmo, këzannë, pa ecë dë du uzëra dë mesi, bëj-si, mëmo, korlajnkënë dë du uzëra dë mesi*. Por ndonjë ilustrim (si *kuqe-si*) tregon se nuk kemi gjithnjë përemër vetvetor<sup>19</sup>.

### 3. Përemri dëftor.

Autori e jep këtë lloj përemri:

a. Sipas gjinisë: *ky / kju / kju, ai / aj /aju (Kju djalë ritet, bëhet maze. / Ai ditë)* për gjininë mashkullore; *kuju,aju (Kuju çupë nuk është sëmërë, / Aju halle)* për gjininë femërore.

b. Sipas rasave: Po sjellim nja dy shembuj: *Dë atë sellë gropë* (r. kallëzore); *Nuk më mer ai çupë* (r. emërore). Autori ka dhënë për rasën dhanore shembullin *Merr Marua, e i la-hi robat asajt babo (asaj gjysheje)*.

4. **Përemri pronor.** Edhe për këtë lloj përemri në monografi kemi një lëndë të bollshme, me rreth 6 faqe (të plotësuar e të strukturuar shumë më

<sup>18</sup> M. Domi, Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, SF, 1965, 2, f. 109

<sup>19</sup> M. Domi, Dh. Shuteriqi shkruajnë për këtë dukuri: “Foljet vetvetore marrin shpesh në mënyrë enklitike *-si* që vjen nga *se* e zgjedhimit vetvetor të bullgarishtes. Por ktë e gjejmë, përveç kësaj, edhe me folje veprorë moskalimtare, por edhe kalimtare. P.sh. *zagaçitsi, gjigjemi, u sëmursi; mbiusi, rënkasi, vetesi, vatkesi; berisi, hapnësi, shpunësi, qitnisi, të sërëtsi, meresi, mblonësi*. Në ndonjë rast të rrallë, ky element i është ngjitur edhe ndonjë fjale jo foljore: *kuqesi, ngrotsi, lartsi*.” Shih M. Domi, Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, SF, 1965, 2, f. 116.

hollësishëm se lënda në artikullin e Domit dhe Shuteriqit), duke bërë organizime e klasifikime sipas vetës, numrit e gjinisë:

- a. Sipas vetës: a.1. v. I: *timja mëmë, times mëmë* etj.;
- a.2. v. II: *jut çupë, tindet vëllazëra* etj.;
- a.3. v. III: *tata-hi, mëma -hi* (ati i tij / i saj, mëma e tij / e saj).
- b. Grupimet i bën dhe sipas numrit të pronës dhe të pronarit.
- b.1. Prona njëjës, pronari njëjës: Pastaja vatkanë motrat mu shpi-him.
- b.2. Prona shumës, pronari njëjës: tindet roba.
- b.3. Prona njëjës, pronari shumës: dë tonë fshat.
- b.4. Prona shumës, pronari shumës: tontë djemëza.

**5. Përemri pyetës:** Çe / Çë / Çi / Çar?; Pse?, Cili? (Në punim janë dhënë shembuj si: *Çe kam bën? Çë ishte ai? Çë të sonë? Çë dosh?*).

Por te ky grup janë përfshirë gabimisht dhe disa ndajfolje pyetëse: ku?, pse? (Pse klan këzani?); ngaha / gaha? (Ngaha jeni?)

**6. Përemri lidhor:** që (... *kur ushtron përpara ni këpucë që ndrin.*)

**7. Përemri i pacaktuar:** *donera, doneri, nishtu (asgjë), gjis (të gjithë).*

**E.** Vend të veçantë në monografinë *Албанският говор в село Мандрица / E folmja shqipe në fshatin Mandricë zë folja*, nga faqja 67 - 147 (në monografi kreu emërtohet **Format foljore / Глаголни форми**)<sup>20</sup>. Lënda që lidhet me foljen, është organizuar sipas mënyrave dhe, brenda tyre, sipas kohëve, sipas diatezave, sipas zgjedhimeve, sipas numrit.

1. Kreu nis me folje në *mënyrën dëftore* (изъявительно наклонение), në kohën e tashme / сегашно време), diateza verpore (деятелен залог), me folje në bashkëtingëllore (глаголи на съгласна), në numrin njëjës (единствено число):

1. a. Në të tashmen e dëftores, foljet më bashkëtingëllore në vetën e parë e të tretë njëjës dalin, si në të folurit e përgjithshëm në gjuhën shqipe pa mbaresë: *hap, mbjell, mar, dal, jap, dremit, mas, kërcas.*

1.b. Në vetën e dytë njëjës këto folje dalin përgjithësisht me mbaresën - *ësh*, duke u njëjtësuar e tashmja e dëftores me atë të lidhores. Autori L. Stankov, shkruan këtu se mbaresa -*sh* është me burim nga bullgarishtja (ти работиш / ti punon). Kjo nuk qëndron ose kërkon argumentim të mëtejshëm dhe referim shkencor të studimet etimologjike referuese. Duhet të nënvizojmë këtu se akademiku Shaban Demiraj, mbaresën -*sh* të vetës së dytë të së tashmes së dëftores dhe të lidhores e sheh si refleks të mbaresës indoevropiane *is*<sup>21</sup>. Gjithashtu, dihet se ndikimi i gjuhëve të huaja në

<sup>20</sup> Людмил Станков, *Албанският говор в село Мандрица / Ludmill Stankov, E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, София, 2016, f. 67.

<sup>21</sup> Shih për këtë, Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 684.

sistemin gramatikor të shqipës është gati i barabartë me zero, dhe kjo së pari shpërfaqet te sistemi i formanteve trajtëformuese.

Në punim pohohet se mbaresa **-ësh** ndeshet dhe në folje në zanore të vetës së dytë, në të folmet e Dibrës: *Ku po shkosh?*

1.c. Në numrin shumëz zakonisht këto folje marrin mbaresat **-m(ë) -n(ni), -n(ë)**.

- veta e parë: *hapmë, mbjellmë, n'jomnë* etj.

- veta e dytë: *hapni, mbillni, n'johni* etj.

- veta e tretë: *hapnë, njohnë, marnë* etj.

1. d. Më tej autori sjell mendimin e Domit dhe Shuteriqit se “te foljet me metafoini në **-e**, në *vetën* e dytë e të tretë njëjës e në *vetën* e dytë shumëz, ka vija të ndryshme, shkaktuar nga analogjia, shtrirje trajtash e tjera veprime analogjike ndonjëherë edhe në paradigmen e së njëjtës folje. Kështu kemi përgjithësisht metafoininë **a** dhe **o** në **e** në *vetën* e tretë njëjës: *aju mer, del, jep, nget, kërcet*; po edhe: *aju njoh*. Por kjo nuk ndodh në *vetën* e dytë që ka zakonisht trajtën përkatëse të lidhores: *japësh, ngasësh kërcasësh*; po edhe *ti mer*.”<sup>22</sup>

Gjithashtu autori sjell të përkthyer në bullgarishte dhe dy dukuritë e mëposhtme:

- Në *vetën* e dytë të shumësit gjejmë ndonjëherë trajta me metafoininë në **i-** (te foljet me zgjerim teme): *kërcas, kërcitni, ngas ngitni*. Në të shumtën e rasteve kjo vetë bëhet vetëm me metafoininë në **-e**: *merni, delni, jepni* etj.

- Te foljet me temë në **-t**, si përgjithësisht në shqip, kjo **t-** është kthyer në **-s** në *vetën* e parë njëjës e shumëz e në *vetën* e tretë shumëz: *ngas, ngasim, ngasnë; mas, masmë, masnë; kërcas, kërcasë, kërcasnë*; po ashtu edhe në *vetën* e dytë njëjës që është veta përkatëse e lidhores së tanishme: *ngasësh, masësh* etj.<sup>23</sup>

1. e. Autori, ka nxjerrë si syth më vete foljet në zanore (foljet e zgjedhimit të tretë), grup foljesh të cilin Domi dhe Shuteriqi e përfshinë në zgjedhimin e katërt<sup>24</sup>: *pi, ri, di, zën, ngrën, fli*. Sipas autorit këto folje, *vetën* e dytë e bëjnë si mbarë shqipja: (*tinë*) *pish, rish, ngrësh, zësh, flish* etj. Në *vetën* e dytë, shumëz te disa folje të këtij grupi ndodh dhe ndërrimi i zanores **ë** në **i**: *ngrëjmë, ngrini, ngrejnë; zëjmë, zini, zejnjë a zenë*.

1. f. Grupin e tretë të foljeve në punim e formojnë, foljet në **-n** (në formën librore mbarojnë me **-j** dhe përfshihen në zgjedhimin parë) të cilat janë parë në numrin njëjës dhe në numrin shumëz.

<sup>22</sup> Людмил Станков, *Албанският говор в село Мандрица* / Ludmill Stankov, *E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, Софија, 2016, f. 68.

<sup>23</sup> Po aty, f. 68 -69.

<sup>24</sup> М. Domi, Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, SF, 1965, 2, f. 111.

1.g. Në vetën e parë dhe të tretë njëjës këto folje mbarojnë më **-n**: *un(ë) pënon, pagon, shkron, dëften, gjen, bën, vjen* etj. Në vetën e dytë mbarojnë me **-sh**: *ti pënosh, pagosh, shkrosh, dëftesh, gjesh, bësh, vish* etj.

1.h. Në shumës foljet e këtij zgjedhimi dalin me mbaresat **-jmë, -ni, -jnë** si në shqipen në përgjithësi: *punojmë, dëftejmë, bëjmë, xallahijmë, vijmë; punoni, dëfteni, bëni, xallahini, vini; punojnë, dëftejnë, bëjnë, xallahijnë, vijnë*.

1.i. Foljet me **-o**, që në këtë të folme në të tanishmen e dëftores e të lidhores e zbërthejnë *atë në diftong*, e kanë këtë zanore të pazbërthyer. Kështu: *un(ë) pagoj, tinë pagosh,aju pagon, neve pagojmë* etj. Rrallë ndeshesh edhe me zbërthim të **-o-** në **-ua-** a në **uo**: *un(ë) lon / luon, ti luosh,aju luon; neve luojmë, ju / ive luoni, ata luojnë* etj.

1.j. Sipas punimit, te ndonjë folje me bashkëtingëllore është formuar një zgjedhim i përzierë, duke marrë mbaresat: **-ën, -ën, -ën** në njëjës dhe **-imë, -ni -inë** në shumës: *un(ë) hipën, ti hipësh,aju hipën, neve hipimë, juve / ive hipni, ata hipinë*.

Autori L. Stankov nuk e jep në këtu edhe zgjedhimin e foljeve *kam* dhe *jam* në të tashmen punim, por në sythin. Në vazhdim të punimit, te sythi “**Zgjedhimi i foljeve**” (Спрежение на глаголи), në faqen 105-107 është dhënë i zgjeruar, përmes shembujsh të shumtë, zgjedhimi i foljes *jam* në të tashmen, të shkuarën dhe në të ardhmen. Po kështu, edhe folja *kam* është pasqyruar në këtë syth (f. 109 -110) dhe në të tria këto kohë, madje edhe në disa mënyra. Kjo përsëri një punë vetjake e autorit në një kohë kur Domi e Shuteriqi kanë dhënë një informacion tepër të shkurtër për këto folje: “Foljet *kam* dhe *jam* zgjedhohen kështu: *jam, je, ishtë, jemi, jeni, janë; kam, kesh, ka, kemi, keni, kanë*. Si shihet në vetën e dytë njëjës folja e parë ka trajtën e vetë dëftores, ndërsa e dyta atë të lidhores.”<sup>25</sup>

1.k. Në një syth të veçantë jepet zgjedhimi jovepror (refleksiv, vetvetor) i foljeve në bashkëtingëllore dhe i atyre në zanore. Folje në bashkëtingëllore dalin me mbaresat **-em, -esh, -et, -emi, -eni, -en**: *lizem, lizesh, lizet, lizemi, lizeni, lizen (lidhem)*. Kurse foljet në zanore dalin me mbaresat **-hem, -hesh, -het, -hemi, -heni, -en**: *ksehem, ksehesh, ksehet, ksehemi, kseheni, ksehen (kthehem)*.

1. 2. Vend të plotë ka zënë në punimin *Албанският говор в село Мандрица / E folmja shqipe në fshatin Mandricë* edhe e **pakryera e dëftores** (минало несвършено време). Lënda është strukturuar në tri sythe: zgjedhimi në numrin njëjës, zgjedhimi në numrin shumës, zgjedhimi pësoro-vetvetor:

<sup>25</sup> M. Domi, Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, SF, 1965, 2, f. 112.

1.2.a. L. Stankov jep tri grupe me shembuj fjalëformash sipas vetave për gjithë foljet:

- Veta e parë njëjës ndërtohet me mbaresën **-n'ja**: *unë hapn'ja, mbilln'ja, mern'ja* etj.

- veta e dytë njëjës me mbaresën **n'je**: *ti hapn'je; mbilln'je, mern'je* etj.

Me shënime të posaçme theksohet se në të dyja vetat nuk kemi fonemën /nj/, por dy fonema të ndryshme të pranëvendosura: **n** dhe **j**.

- veta e tretë njëjës me mbaresën **-ish**: *hapish, mbillish, merish* etj.

Autori sjell të përkthyer në punim edhe shënimin se në ndonjë rast veta e tretë ndërtohet me mbaresën **-esh**: *hem llotëronesh, hem këndonesh*.

1.2.b. Më tej vjen numri shumësi i së pakryerës së foljeve:

- Veta e parë shumësi ndërtohet me mbaresat **-imë / -jimë**: *mbillimë, hapjimë, njohimë, dremit(j)imë* etj.

- Veta e dytë shumësi ndërtohet me mbaresat **-ishtë** të foljet më bashkëtingëllore e me **-nishtë** të foljet më **n** a më zanore: *juve /ive hapishtë, mbillishtë, murishtë* etj.; *punonishtë, shkruonishtë e shkronishtë, ngrënishtë, zënishtë, rinishtë* etj.

- Veta e tretë shumësi ndërtohet me mbaresën **-inë / -jinë; -ninë**: *mbillini, hapjinë, njohin, dremit(j)inë, dilninë* etj.

1.2.c. Në punim theksohet se në analogji me vetën e dytë, janë krijuar për vetën e parë dhe të tretë shumësi edhe trajta me fundoret **-ishmë** ose **-ishimë**, përkatësisht **-ishnë** ose **-ishinë** të foljet më bashkëtingëllore dhe me fundore **-nishmë, -nishnë** dhe **-nishninë** të foljet më **-n** a më zanore: *jepishinë / jepinë, njohishnë, jecënishnë; binishnë / bininë, flinishmë, dinishnë, linishnë, zënishnë, rinishnë*.

1.2.d. Ka edhe raste kur trajtat me **-sh** janë përgjithësuar për gjithë vetat e shumësit: *xallahismë, xallahishtë, xallahishnë*. Kjo folje e një folje tjetër në **-in** si ajo, në shumësi nuk dalin me fundoret **-nishmë, -nishtë, nishmë** si foljet e tjera, po me fundoret **-ishmë, -ishtë, -ishnë**: *blanirishnë qengetë* (blegërijnë qengjat).

1.2.e. Foljet ndihmëse në të pakryerën e dëftores dalin me trajtat:

- Folja **kam** del me paradigmen: *Unë kisha, tunë kisha, aju kish, neve kishmë, ive kishhtë, ata kishnë; si dhe me trajtën e aoristit klesha*.

- Folja **jam** del me paradigmen: *unë isha, tinë ishe, aju ishte, neve itishmë, ive itishtë, ata itishnë*. Format e shumësit të kësaj folje (*neve itishmë, ive itishtë, ata itishnë*) janë nga të paktat mospërputhje me vëzhgimet e sjella nga Domi dhe Shuteriqi. Këta japin për foljen *jam* vetëm format e njëjësit dhe jo të shumësit: *unë isha, tine jesh, ato ishnë*<sup>26</sup>. Do të

<sup>26</sup> M. Domi, Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, SF, 1965, 2, f. 113.

ishte e nevojshme dhe e domosdoshme të kishte ilustrime me thënie a tekste të ndryshme, për të vërtetuar këto forma tejvajtëse.

1.2.f. Ndonjëherë te disa folje, për të pakryerën, përdoret trajta e së kryerës së thjeshtë, e aoristit. Për foljen *vjen*, e pakryera *jerça, jerçe, jertz ose erz, jermë, jertë jernë* etj. Stankov i mëshon pohimit të Domit dhe Shuteriqit se këtu “kemi këtu pasojën e një ndikimi të bullgarishtes me qenë se në gjuhët sllave ekziston një trajtë e vetme foljore për kohët e kaluara”<sup>27</sup>.

1.2.g. Në punim është marrë edhe një rast i së pakryerës me **-sh**, që të kujton të pakryerën sekondare të gegërishtes së sotme: *nuk i ngitshinë (nuk i ngitinë)*. Autori ka përkthyer edhe mundësinë se kjo mund të shpjegohet edhe si e ardhur, nga forma me *-ishnë*.

1.2.h. Në ecurinë e organizmit të kohës së tashme, edhe tek e pakryera, L. Stankov ka nxjerrë si syth më vete zgjedhimin vetvetor:

- Foljet në bashkëtingëllore e formojnë këtë formë me mbaresat **-en'ja, -en'je, -enish, -enishmë, -enishtë, -eninë**: *hizen'ja, hizen'je, hizenish, hizenishmë, hizenishtë, hizeninë (hidhesha)*

- Kurse foljet në zanore me mbaresat **-hen'ja, -hen'je, -henish, -henishmë, -henishtë, -heninë**: *gëzohen'ja, gëzohen'je, gëzohenish, gëzohenishmë, gëzohenishtë, gëzoheshinë (gëzohem)*

1.3. Vend të veçantë në punimin që kemi në duar ka zënë dhe e kryera e thjeshtë / aoristi i foljeve (*минало свършено време, аорист*). Edhe këtu lënda organizohet në dy zëra: *diatezën veprorë dhe në diatezën vetvetore*.

1.3.a. Në të folmen e Mandricës ndeshen shpesh foljet në zanore që e ndërtojnë aoristin me **-t**: *ëndërita, punojta, këcejti, shkojti, shtrojti, mbrejti, ushqejti, këndoji* etj.

1.3.b. Edhe pse sythi ka synuar të përfshijë të kryerën e thjeshtë të foljeve në diatezën veprorë, L. Stankov, duke sjellë përkthimin e lëndës së artikullit të Domit dhe Shuteriqit, ka përfshirë edhe forma vetvetore mesore foljesh që e ndërtojnë këtë formë me **-t**: *u zgjuvejt (për: u zgjua), u gëzit (për: u gëdhi), u shuetnë*.

1.3.c. Ka dhe raste të aoristit sigmatik me **-sh**. Veta e parë: *klesha, lasha, rasha, thasha, mbetsha, jerça*; veta e dytë: *kleshe, lashe, rashe, jerçe*. Kurse veta e tretë, njëjës dhe vetat e shumësit, janë pa **-sh**: *kle, klemë, kletë, klenë; la, lamë, latë, lamë*.

1.3.d. Te foljet që në aoristin asigmatik mbarojnë me bashkëtingëlloret lëngëtore **l, ll, r**, në vetën e tretë njëjës, jo vetëm në pësore-vetvetore, por edhe në veprorë, del rregullisht trajta pa mbaresë: *nuk i mor, muar, më muar kaikçiu: duoll, duall; suoll* etj. gjithashtu, sipas punimit të foljet në **-l, -ll** me

<sup>27</sup> M. Domi, Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, SF, 1965, 2, f. 113.

apofoni në aorist, në vetën e parë e të dytë njëjës kemi trajtë me *o* të pazbërthyer në diftong, pse kjo ndodhet në rrokje të hapët, ndërsa në vetën e tretë njëjës zakonisht dhe në vetat e shumësit kemi trajta me zberthim në diftongun *uo*: *dolla, dolle, duoll, duollmë, duolltë, duollnë; mbolla, mbolli, mbuoll ose mbolli, mbuollmë, mbuolltë, mbuollni*.

1.3.e. Në shumës mbaresat janë *-më, -të, -në*: *mblonë / mbluanë, jertë, jernë (erdhnë), vlojtnë*.

1.3.d. Në punim, në një syth të veçantë, theksohet se në diatezën pësore-vetvetore përdorim më të gjerë ka aoristi sigmatik: *(unë) u gëzuosh, (ti) u gëzuoshe; u lakça* etj. Aoristi formohet si në shqipen e përgjithshme, nga trajta përkatëse e vepronës prirë nga pjesëza përemërore vetvetore *u*: *u sasha, u sa, u hoza; u gëzuokam, u gëzuokeni*. Përmes shembuj të bollshëm jepet ilustrimi për këtë formë foljore: *Ku u zborëtë (humbët). Marua u nis të gjejë ujënë. Fshati u bë deri në katër kint shtëpi* etj.

1.4. Formimi i *pjesores* së foljeve (Образование на причастия) në monografi është trajtuar si çështje e veçantë. Ai ka karakter mbarëshqipe. Në të folmen e Mandricës dallon formimi i pjesoreve me temë në bashkëtingëllore, ato nuk formohen me *-ur* (si në shqipe), por me *-or*: *mbjulltor (mbyllur), mblojtor (bluar), pjekor (pjekur), tertor (tharë, terur)* etj. Gjithashtu janë dhënë dhe rastet *ndarë, pjellë, vrarë, bënë, (bërë), zënë* etj.<sup>28</sup>

1.5. Syth i veçantë është dhe *formimi i emrave nga pjesoret*. Emrat dalin pa nyje të përparme: *Kuju bukorë çupë nuk ishte-si sumurë, po ishte përë vjezorë* (vjez - vjedh, për grëmbim / për martesë). *Pëstaj, nga nxitorë, bitiska dë baltërat: u mbetka nera këpucë!*

1.6. **Koha e kryer** (минало неопределено време), në këtë të folme, ashtu si në mbarë shqipen, ndërtohet me *kam + pjesore*, në zgjedhimin vepror, dhe *jam + pjesore*, në zgjedhimin pësor-vetvetor: *Unë kam gjegjur nga time tatë... Këtu jam pjellë, në Mandricë*.

1.7. **Koha më se e kryer** jepet së bashku me atë të tejshkuar (минало предварително време). Më se e kryera ndërtohet me të pakryerën e foljes *kam (kisha) + pjesore*, në zgjedhimin vepror. Autori ka dhënë dy shembuj:

<sup>28</sup> Domi e Shuteriqi e japin më të plotë këtë çështje: “Në pjesore foljet me zanore dalin në trajtën me prapashtesën *-rë*: *larë, punuarë*; foljet me bashkëtingëllore në trajtën me prapashtesën *-ur(ë)*: *dremiturë, hapurë*; ato me bashkëtingëllore lëngëtore dalin në trajtën me *-ë*- si prapashtesë: *mbjellë*. Në mjaft raste, duke u formuar në bazë të aoristit më *-ta* ose për analogji me të, pjesorja del me fundoren *-tur*: *(ka) martur* (për: *marrë*), *këndojtur, shkrojtur, mbyllur*. Ja trajta e pjesores për ndonjë folje tjetër: *u ka bënë, ka vdesur*.” Shih më gjerë: M. Domi, Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, SF, 1965, 2, f. 115.

*Kisha bën (Kisha bërë)*. Për formën jo veprorë jepet shembulli *Unë kleshë gëzuar (qeshë gëzuar)*.

1.8. **Koha e ardhme** (будеще време) e mënyrës dëftore zë dy faqe në monografinë *Албанският говор в село Мандрица / E folmja shqipe në fshatin Mandricë* (f 81-83).

1.8.a. Forma e kësaj kohe ndërtohet me pjesëzën **do** të reduktuar në **o**, të bashkuar me lidhoren e tanishme: *këzanet o t'i pagëzosh; Ze nai sefte sanë që o t'bëjnë kooperativë sade hushërat (fushat), a dë ballkanet me geç; un o t'e mar, aj o t'të haj; o t'lishoni berat; nuk o t'vemë, nuk o t'veni, o t'vejsh dë klisë, o të jam, o të kam*.

1.8.b. Sipas punimit, koha e ardhme e foljeve formohet dhe me foljen **kam + formën e lidhores**, që është e zakonshme në arbërishten e Italisë: *S'ka të shkosh donjëherë dë ...*

1.8.c. Gjithashtu në këtë syth jepet një informacion për këtë kohë në të folmet shqipe në fshatrat e Ukrainës: *un ot (o t') shkrun, ti ot shkruanësh,aju ot shkrunë*. Më tej jepet një informacion për forma të ndryshme të së ardhmes në toskërishte (Mallakastër, Korçë, Gjirokastrë, Përmet), mbështetur në studimin e prof. Emil Lafes (Por studimi nuk citohet dhe nuk jepet as në Bibliografi në fund të librit.).

1.8.d. Një vend shumë i vogël i jepet të ardhmes të së shkuarës: *Ato që vinishnë kutu, o t'bëheshin arnautçe kutu*.

2. **Mënyra lidhore** (Подчинително наклонение).

2.1. Autori shkruan, gjithnjë duke përkthyer punimin e Domit e Shuteriqit, se mënyra lidhore ndërtohet me pjesëzën **të**: *t'e pres, t'e hamë, kush t'e shtroj; kur shohësh me bardë kalë... të më ngrësh*; por dhe pa **të**: *kur bjerë shi; kur shkojë bletha, o t'i pudavitë*.

2.2. Veta e dytë njëjës e lidhores së tanishme del me mbaresën **-sh**, te foljet më bashkëtingëllore del zakonisht me **ë**, në ndonjë rast të rrallë me **-i-** (ti *mbjellësh, shohësh, hapish dhe hapësh*); te foljet me **-n**: ti *të punosh, të dëftesh, të lash*), rrallë me **j**: *t'vejsh*.

2.3. Veta e tretë njëjës ka mbaresën **ë**, si në gjithë dialektet e shqipes: *t'dalë, të marë, të dremitë, të shkojë* etj.

2.4. Format e foljes **jam** dalin: *të jam, të je, të ishtë, të jemi, të jeni, të janë* (si shihet përdoren trajtat e dëftores); kurse format e foljes **kam** janë: *të kam dhe të kem, të kesh, të kaj, të kemi, të keni, të kanë*.

3. **Mënyra kushtore** (Условно наклонение) në të folmen e Mandricës formohet me pjesëzën **qosh** dhe me të tashmen e lidhores: *unë qosh punon, ti qosh punosh,aju qosh punojë, neve qosh punojmë, ive qosh punoni, ata qosh punojnë* etj. L. Stankov i referohet prof. Emil Lafes për origjinën e formës *qosh*: *qofsha punon > qosh punon* “në qoftë se punoj”.

3.1. Stankovi ndalet dhe te *koha e kryer e kushtores* por shembulli i sjellë për ilustrim nuk i përket kësaj mënyre e kësaj kohe: *Ti prift, të kleshe ndë vent tim, çë kesh bësh (bësh)? ... O të kisha dremitur.*

4. **Mënyra habitore** (Удивительно наклонение) zë rreth 5 faqe në punim.

4.1. **E tashmja e habitores**, si në shqipe dhe në të folmet shqipe të Ukrainës, edhe në të folmen e Mandricës është trajta kohore e zakonshme e tregimeve a rrëfenjave popullore, duke u përdorur shpesh veta e tretë e njëjësit apo e shumësit: *Ni dit rënka shumë shi. Kur vatika, qit robotë, bëhet gollapar... Zëndëri, kur vatika dë shtëpi, vesh robotë jashtë.*

4.2. Foljet më **-o** (Stankov përdor foljet në **-on**) dalin në disa forma:

4.2.a. Me o të diftonguar **-uo-**: *martuoka; u martuokan, punuoka, u gëzuaka* etj.

4.2.b. Me **-o-** të pazbërthyer: *mësoka, vloka.*

4.2.c. Haset një trajtë me **t** të shtuar: *shkotkan, ushtrotkan, shuetkan* (khs. *pënojtka* të të folmes shqipe të Ukrainës), *ngatka* (për foljen *ngas*).

4.2.d. Në analogji me vetën e parë njëjës të së tanishmes dëftore, del trajta me **j**: *ngërkojkan, mbajka*; ose me **j** dhe me **t** për analogji me temën e aoristit: *lishojtkan*; ose me **-n-** dhe **-t-** për analogji me trajtat e së tanishmes e të aoristit njëkohësisht: *mentonka.*

4.3. Trajta të tjera të habitores janë: *prekan, jerdëkan* dhe *erkan* (*erdhëkan*), *erthka, sënka, serkanë, sërítkanë, vatika, vatkanë, hëngërkan, dashka, shpuka.*

4.4. Në vetën e tretë njëjës gjejmë ndonjë trajtë me fundoren **-kaj** pranë asaj me **-ka**: *zënka / zënkaj, bëka / bëkaj.*

4.5. Foljet me pjesoren me **në** kanë trajta pa **n**: *klekan, vëka zëka*; rrallë trajta me **n(ë)**: *rënka, zënka, thënkkan.*

4.6. Foljet **jam** dhe **kam** në habitoren e tanishme dalin: *klekam, kleqe, kleka, klegemi, klegeni, klekan; paskam, paskam, paka.*

4.7. Në një syth më vete, të emërtuar **Përjashtim** (Исключение) jepen përdorime të izoluara, si rasti i habitores shumë për të tashmen e dëftores: *Demek, ne klekemi nga Korça, nga Albania... që klegemi ne arnautë nga toni Shqipëria.*

4.8. Më tej në sythin **Zgjedhimi pësor - vetvetor**, jepen mbi një faqe shembuj me thënie të ndryshme: *Ni kohë, ni dalë u vloka dë jatër fshat... Kur u niska të vejë Marua, qeni zhautllika, sënka. Motrat u bëkan avgiitka. Bëkan shtëpi tri vallazëra, u martuakan.*

4.9. L. Stankov ndalet gjithashtu te forma *u lakça* (pohon se sipas E. Lafes, kjo formë i takon gegërishtes së shqipes), duke synuar të bëjë lidhjen me format *u lagëshka, u lagëshke* etj. për të cilat thotë se përdoren tepër rrallë.

5. **Mënyra dëshirore** (Желателно наклонение): *Unë mbetsha shumë dovolen nga juve (U mbeta i kënaqur nga ju).*

6. **Mënyra urdhërore** (Повелително наклонение). *Ngro-si nesër sabale.*

7. Pranë kësaj mënyre është dhe një informacion i shkurtër për formimin e formës pyetëse të fjalive. Foljeve u shtohet pjesëza **-li**, një ndikim nga bullgarishtja: *Keni-li shtëpi? Keni-li rabë? Vërtet-li?*. Por mendojmë se ky informacion nuk duhet të ishte këtu. Ai mund të zinte vend normalisht në kreun për sintaksën dhe llojin e fjalive sipas kumtimit.

8. Në punim jepen dhe dy foljet modale: **duhet** dhe **mund**: *Dufet të vetë se u bë geç (errësirë). Mun' të kaj nikint vjet. S'mun' të jecën.*

10. Në vazhdim, monografia *Албанският говор в село Мандрица / E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, ndalet te një grup i madh foljesh, duke dhënë elemente të paradigmave të zgjedhimit (përgjithësisht zgjedhimi sipas kohëve e rrallë sipas mënyrave) për secilën njësi. Vetë sythi "**Zgjedhimi i foljeve**" (Спрежение на глаголи) me 55 faqe (92-146) është një punë vetjake e L. Stankovit. Foljet janë nxjerrë nga fjalori i përgatitur nga Dh. Shuteriqi<sup>29</sup>, por edhe nga lënda dialektologjike, e folklorike (rrëfenjat e këngët etj.) të regjistruara në të folmen e Mandricës. Ato janë dhënë me jetën e tyre në shembuj të ndryshëm të nxjerrë nga kjo lëndë. Në ndonjë folje gjejmë dhe përkatësinë burimore (fjalë *shqipe, bullgarizma, turqizma, greqizma, sllavizma*). Aty gjen lëndë interesante për shumë folje. Fjala *vjen*, folja *jam* formon një zë të mirëfilltë me rreth dy faqe, duke u shpalosur një informacion gjuhësor i gjithanshëm<sup>30</sup>.

Po japim për ilustrim vetëm një folje (*jap*), duke mos dhënë përkthimin e shembujve në bullgarishte: **Јар - давам**:

**M. dëftore, e tashme / Сер. време**: *јар - давам, јарëш - даваш, јер - дава, јармë - даваме, јерни - давате јарнë - дават:... që epen ka uza (që vijnë nga udha); ... t'i japnë.*

**M. dëftore, e kryer e thjeshtë / Мин. св. време**: *... pa kur i zasha zjarnë; ... i za - him konak Stanua; zasha (dhashë): pa i za him Perëndija mashkull djal', mashkull djal', mençme djal'. Dimçua i za-hi kalit-si ni shinik jelp ze ni shinik verë. ...që i za selamnë.*

**M. dëftore, e pakryer / Мин. несв. време**: *jipn'ja, jepn'je, jepish, jepishmë, jepishtë, jepinë.*

<sup>29</sup> Dh. S. Shuteriqi, *Fjalorth i të folmes shqipe të fshatit Mandricë (Bullgari)*, SF, 1965, 2.

<sup>30</sup> Людмил Станков, *Албанският говор в село Мандрица / Ludmill Stankov, E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, София, 2016, f. 105-107.

**M. habitore, koha e tashme / Удивительно наклонение, сег. време:** *Stane, mori bukur Stano, tine paske mashkull djal', mashkull djal', mençme djal'.*

**Подчинително наклонение, сег. време:**... *ferman të të japë...; të të japmë-li, mari Millke-le?; ...mbreterlik ti jape...*

**Повелително наклонение + Подчинително наклонение:** *Jep para. Jep para e të marrësh nuse. A n'doni, mëto, jepmëni.*

**F. Ndajfoljet (Наречия).** 1. Në rreth 2 faqe jepen dhjetëra ndajfolje a shprehje ndajfoljore në thënie apo jashtë tyre, por pa bërë asnjë lloj klasifikimi apo grupimi, semantik apo strukturor: *lashtë, tashi / tashti, nesrë, cing (pak), tar (shtrenjtë), anthe (kastile, enkas), ca pak shumë kohë, mbrëmnet o t'hamë bukë, Shko niset (arin) treni? Këtëj lartmen klishe, drutë anthe i prekan.*

2. Në punim jepet dhe shkalla krahasore e ndajfoljeve, që formohet me pjesëzën **me**, duke dhënë 4 njësi: *geç – me geç (vonë -më vonë), lashtë – me lashtë; mirë – me mirë etj.*

3. Por ndonjë njësi nuk është ndajfolje, si: **pëp** *neve ni (kurse ne na)* (lidhëz); *sollaku anë (ana e majtë)* (emër me mbiemër)

**G. Parafjalët (Предлози):** Në punim (mbi 6 faqe, 148-154) jepen 16 parafjalë (Domi e Shuteriqi japin vetëm një<sup>31</sup>). Edhe këtu nuk kemi grupime semantiko-funksionale apo strukturore, edhe pse për disa prej syresh jepet rasa e përdorimit. Vendin më të plotë e zë parafjala **ndë (në), që** përdoret zakonisht në formën **dë** me rasën emërore të shquar të emrit: *dë guri, dë kali, dë kumi etj.* Kjo parafjalë herë herë del me kallëzoren e pashquar: *dë Sofje, dë vreshtë, dë ni lartë kodrë...; pa më duall dë zëmërë ni shimshir.* Duke iu referuar dhe trajtesave të prof. E. Lafe, Stankovi sheh dhe përdorimet e kësaj parafjale, sinonimike me përdorimet e parafjalës **te**. Një nga këto raste është ai me përemrat në kallëzore: *t'vini prapë dë mua.*

Krahas punës së vlerësueshme, duhet të pranojmë se ndonjë njësi nuk është dhënë saktë. Kështu në ndërtimin *Ngaha jeni? Ngaha* është ndajfolje e jo parafjalë.

**H. Te sythi Pjesëza (Частица)** jepen pjesëzat *nuk / nuku, sun (s'mund), ne (as): në jerm, në djellë.*

**I. Kurse te sythi Lidhëzat (Съюзи)** jepen lidhëzat *hem..., hem, që* (e barasvlerëshme me *për të: Dilni jashtë për të munt të merrni uzo / dilni jashtë që të merrni ujë.*) etj. Më tej, nën zërin **Съюзни думи** (shprehje lidhëzore) jepet konstrukti *për çime*. Për ilustrim jepen shembujt: *Kutu nuk e bënishmë*

<sup>31</sup> M. Domi, Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, SF, 1965, 2, f. 115.

përpara, për çime nuk ishte udopsta të bëhet kooperativ; nuk kishte pranë makina, por mund të ni ndihmë dhe punë.

**III.** Kreun e tretë në punimin *Албанският говор в село Мандрица / Е folmja shqipe në fshatin Mandricë*, e zë **Sintaksa**.

1. Kreu nis me sythin **Vendi i përcaktorëve** (Място на определението). Përcaktorët / atributët (mbiemra dhe përemrat pronorë), vendosen përpara emrit që përcaktojnë. Kjo nuk ndodh vetëm në të folmen e Mandricës, por edhe në të folmet shqipe të Ukrainës, dukuri që vjen nga ndikimi i bullgarishtes: *bukurë çupë, mençme djalë, kalsërë flakë, gjelbërë flakë, vjetërë verë, maze shtëpi, ndë vjetëra fshat, ndë të ngushta sokak* etj. Ka edhe ndonjë rast kur mbiemri qëndron pas emrit: *...ze për kadënën mavrutë*.

2. Syth më vete formojnë **Togfjalëshat** (Словосъчетания). Gjithashtu, nën ndikimin e bullgarishtes, emrat e rasës gjinore krijojnë togfjalësha, pa një të përparme dhe duke iu paravendosur emrit që përcaktojnë: *djados shtëpi (shtëpia e gjyshit); mëmësë porta (porta e mëmës); Ristos mëmë (mëma e Ristos), djellës lule (Luledielli) barkut zëmborë (dhimbja e barkut); këzanit mëmë (mëma e fëmijës), mbretit bilë (bija e mbretit)* etj.

Këtu gabimisht është dhënë fjala e përbërë (pra, që nuk është togfjalësh) *zesëtundurë* (tërmet), edhe pse ajo e ka origjinën nga togfjalëshi *zesë tundurë* (të tundurit e dheut).

3. L. Stankov ka veçuar, brenda kreut të sintaksës, sythin “Togfjalësha në funksione të ndryshme” (Словосъчетания в различни функции), duke dhënë raste të përdorimit të tyre në dy rasa (por pa u ndalur në funksionet e tyre sintaksore):

a. Në rasën emërore: *Këzanit mëmë ishte kujë. Vete mbretit bir të putisë kalnë*.

b. Në rasën kallëzore: *Kam sëmure bilësë bur*.

4. Në një syth tjetër jepen përdorimi i parafjalëve para këtyre togfjalëshave: - **dë**: *dë verës kohë*; **ga**: *vjen ga kasabasë centër*; **për**: *...për çorbaxhiut çupë*; **pranë**: *pranë dhe fshatit centër*.

5. Në vijim në kreun për sintaksën, punimi për të folmen e Mandricës ndalet te ndërtimi i **fjalive qëllimore** (Образуване на изречения за цел).

5.1. Autori ndalet sidomos te ndërtimet me një trajtë foljore të formuar nga lidhorja e prirë nga parafjala **për**: *Tatja e bëka konaknë për t'i japmë konak. Turqet ndejtan për të hanë bukë. Unë o t'i jap kartë, senet nga mua, për të ishtë tuoj aju vent* etj.

L. Stankov, duke iu referuar artikullit të Domit dhe Shuteriqit, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, shprehet se kjo dukuri ndeshet dhe tek arbërishtja e Greqisë (*i shkruajmë këto për të dëftojmë*). Gjithashtu ai nënvizon se forma të tilla ndeshen dhe në të folmen e fshatrave arbëreshe të

qarkut të Molizes, Itali (*Vinja prapa për të bëja shok.*), por edhe në fshatin Muzinë afër Delvinës, Shqipëri (... *kam edhe tjetër për t'i jap...*). Kjo pjesë, edhe pse është mbështetur te punimi i dy profesorëve shqiptarë, ka përsëri (si në shumë sytha e kapituj për të cilët jemi shprehur më lart) lëndë ilustruese (rreth një faqe e gjysmë), të qëmtuar me kujdes nga L. Stankov. Kjo vërehet nga një përjasje formale me punimin e profesorëve<sup>32</sup>.

Gjithashtu, autori jep një tipar tjetër të variacionit sintaksor të kësaj të folme, përdorimin e *pjesores së substantivuar në vend të paskajores*: *Kuju çupë nuk ishte sëmurë, po ishte për vjedorë* (ishte për t'u rrëmbyer / për t'u vjedhur / për t'u martuar). Por kjo nuk është fjali qëllimore. Përdorimi (*ishte për vjedorë*) del si kallëzuesor i kryefjalës. Ndonjë shembull duhet të jepej në thënie të plotë që të mund të gjykosh për funksionin sintaksor të tij. P.sh., ndërtimi ... *për munt të ri*, nuk duhej të jepej kështu, sepse fjalia qëllimore është pjesë e nënrenditur, ndaj duhej dhënë edhe pjesa nga varet.

5.2. Një ndërtim tjetër i fjalive qëllimore në të folmen e Mandricës janë ato me lidhëzën qëllimore **që** + pjesëzën **të** (за да): ... *mos shohnë që prekan drutë, që t'e bëjnë klishën*. Ndeshet dhe ndërtimi me pjesëzën mohuese **mos**, por pa lidhëzën **që**: *Bëka të fshihet ima-hi, mbretit gruvë, mos e shohë mbreti*.

6. Pak vend ka zënë ndërtimi *i fjalive shkakore* (Образуване на изречения за причина). Ato ndërtohen me lidhëzën **se**: *Ku jërçe, biro? Të ikësh sot, biro, se o t'të haj drakua. / Nuse, nuse, djallë të marrë, zjarri të djegë, se më ndoze shtëpinë*.

7. Fjalja e nënrenditur (Подчинено подложно изречение)

Janë dhënë dy shembuj që semantikisht të çojnë në dy lloje të ndryshme fjalish, por që në punim nuk janë dalluar:

<sup>32</sup> Domi dhe Shuteriqi shkruajnë: Në sintaksë për t'u përmendur është edhe ndërtimi i fjalive qëllimore me një trajtë foljore të formuar nga lidhja prirë nga parafjala *për*, dalë duket nga kontaminimi i dy mënyrave të zakonshme të shprehjes së fjalive qëllimore, me lidhoren dhe me shprehjen me vlerë paskajoreje <për + pjesoren e substantivuar asnjëherë me një (: *shkoj të thëres mjekun, / shkoj për të thirur mjekun*). Shembëlla: *tatja e bëka konaknë për t'i japmë konak; turketë ndejtkan për të hanë bukë* (Kënga 4a);... *për të mund të rri...*; *për të mund merni uzë*. E njëjta formë dhe i njëjti ndërtim dalin edhe në arbërishten e Greqisë (: *bëri të fjeturin, për të shih çë do t'apobënej; i shkruajmë këto për të dëftojmë*; shih A. Xhuvani, Studime gjuhësore, f. 24), po ashtu edhe në fshatrat arbëreshe të Molises: *E për-t pëskuor dish veja te lumi (= e për të peshkuar doja të veja te lumi)*. *Vinja prapa për të bëja shok*. Shih A. Cirese, *Canti popolari delle colonie albanesi del Molise*, Rienti 1958, f. 18, 24). Ndeshet edhe në të folmen e fshatit Muzinë pranë Delvinës: *kam edhe tjetër për t'i jap* (M. Totoni, E folmja e Muzinës). Shih për këtë: M. Domi, Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, SF, 1965, 2, f. 119.

– *Vete mbreti, gjigjet këzani që kla (... fëmija që qan)* – fjali përcaktore  
 – *Të shihn'je që erz ni çupë, që ndrinish klisha, që u shuettë kandiletë.* – fjali kundrinore.

**IV. Pjesa e katërt** (edhe pse në punim nuk emërtohet kështu, madje është përfshirë në kreun e *sintaksës*) përfshin rreth 90 faqe, me lëndë të përkthyer që përfshin intervista, si dhe lëndë folklorike, vjelë në ekspeditën treditore të Dh. Shuteriqit në Mandricë në vitin 1959, botuar në revistën “Studime filologjike”, 1965/1 në rubrikën “Materiale e dokumente”, me titullin “*Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica. Studim dhe tekste*”<sup>33</sup>. Por aty gjen lëndë folklorike edhe të ndonjë studiuesi tjetër<sup>34</sup>.

1. Fillimisht jepen në shqipe dhe të përkthyer në bullgarisht 10 intervista me banorë të Mandricës (marrë nga punimi i Dh. Shuteriqit<sup>35</sup> dhe përkthyer në bullgarishte nga L. Stankov), të cilat lidhen së shumti me origjinën e këtyre banorëve, por edhe me jetën në vitet 50. Kjo lëndë, në artikullin e Shuteriqit është pas përrallave. Po japim një pjesë:

*Fshati kutu kle arnautë. Ni mandrë paska: nga mandra u mbetka kutu. 3. Tri hanë klekanë; nga tri u bëkan gjashtë; gjashtë klekan, kurdiskanë mandrënë. Mandrënë si e kurdiskanë, klekan çobanë, - zejnë beratë. Ni bylyk bera paskanë. Atë bylykun bera, ... këta ni nga ni klekan tri vllazëra. Ata tri vëllazëra bëhenë zjet hanë. Gjis gjis u shtuokanë, u bëkanë ni qint hanë. Ato ni qintat hanë nishnë të merenë, nishnë të japnë ni me ni. Këtej lartmen klisë, drutë anthi i prekan. Papo Todori e mbajka mënt kur klekan tri çobanë. Kur e bëkan klisë, natën e kurdiskan, mos shohnë që prekan drutë, që t'e bëjnë klisë. U bëka maze fshati, gjer dë katrë qint e gjashzjet hanë. Aqe e mba mënt unë. Gjis arnautë klenë, t'huoj nuk kish, hiç nuk paska. Tontë merinë nga huojtë, - nuk sosnë çupat: çupat klënkak, djemtë më shumë klënkak. Pëstaj u trazuan shkllira me arnaut.*<sup>36</sup>

2. Grupin e dytë të lëndës së mbledhur në fshatin Mandricë, e përbën sythi “Këngë” (Песни), ku jepen 17 këngë (disa me dy, por edhe me tri

<sup>33</sup> Dh. S. Shuteriqi, *Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica. Studim dhe tekste*, SF, 1965, 2.

<sup>34</sup> Para nesh, në Mandricë ka shkuar shkrimtari Kolë Jakova, i cili botoi edhe një artikull të shkurtër, ku futi pak lëndë gjuhësore dhe një këngë shumë interesante mbledhur prej tij: Një vizitë në fshatin Mandricë, te rev. “Nëndori” 1957, nr. 12. Ribotojmë në «Shtojcë», nr. 2, këngën e mbledhur prej tij. Po aty, nr. 1. botojmë këngën që na dërgoi nxënësi ynë më 1949 dhe që është një variante e «Këngës» 2, të mbledhur prej nesh.

<sup>35</sup> Dh. S. Shuteriqi, *Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica. Studim dhe tekste*, SF, 1965, 2, f. 135.

<sup>36</sup> Людмил Станков, *Албанският говор в село Мандрица / Ludmill Stankov, E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, София, 2016, f. 167-168.

variante), si dhe dy këngë me shënimin shtojcë (Допълнения), ashtu si janë dhënë në artikullin e prof. Dh. Shuteriqit<sup>37</sup>. Këtë syth e çel një përkthim në bullgarishte i disa pjesëve të këtij artikulli. Po shkëputim:

*“Folklorin e mblodhëm si e solli hera, kudo dhe kurdo. Nuk arritëm të mbledhim këngët rituale, të cilat do të mund të na jepnin një ide mbi gjendjen e folklorit të vjetër shqiptar sot në Mandricë. Këngët që mblodhëm, zor të thomi se kanë të bëjnë me folklorin e njohur të Shqipërisë dhe të kolonive arbëreshe. Ato duket të jenë krijuar në vend, nën ndikimin e këngëve bullgare. Ndonjë prej tyre, mësuam se thuhet edhe bullgarisht, si kuptohet dhe prej brendisë: Kënga 14, “Tudorqe, bukor Tudorqe”, ku flitet për hajdutin e famshëm bullgar, Karaxhanë, i cili luftoi kundër turqëve në shek. XIX. Sidoqoftë, ndonjë këngë na duket se ka elemente mjaft të vjetra. Kënga 11, “Engjelinko, toglë çupë” bën fjalë për detin. Ky fakt mund të lejojë supozimin se në Mandricë janë vendosur edhe bregdetas. Kënga 10, “Bilbili këndon në shkozë”, fillon me një varg tipik të folklorit shqiptar. Po hyrjet e pothua gjithë këngëve, me vargun e tyre të parë, me fjalën “mëmo” ose “mëmo-lo”, janë tipike të këngëve bullgare. Emrat e personave për të cilat flasin këngët, janë gjithashtu gati të gjitha bullgare.”<sup>38</sup>*

Autori L. Stankov e ka parë të arsyeshme të japë të përkthyer përfundimin e prof. Shuteriqit për origjinën e pasurisë folklorike të mbledhur në Mandricë. Në Punim citohet në bullgarishte se “I vetmi përfundim që mund të nxjerrim nga sa thamë, është se ne njohëm pak ase tepër pak folklor që të mund ta kishte origjinën prej Shqipërie. Ndikimi i madh i folklorit bullgar mbi folklorin e Mandricës, kur është fjala për këngët, duket lehtë. Po fakti që ne nuk mblodhëm këngët rituale, na bën të mos japim dot një mendim më të plotë mbi këtë çështje.”<sup>39</sup>

### **Ne jerë, mëmo, ne djelë...**

*Mëmo-lo, mëmo bukorë,*

*ne jerë, mëmo, ne djelë.*

*Pa m'u sëmur çupa,*

*pa sëritnë heqimet,*

*heqimet me xharahet.*

*Pa nisë, mëmo, të zallahijnë*

*heqimet me xharahet:*

*“Kuju çupë nuk isht sëmurë,*

<sup>37</sup> Dh. S. Shuteriqi, *Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica. Studim dhe tekste*, SF, 1965, 2, f. 111.

<sup>38</sup> Людмил Станков, *Албанският говор в село Мандрица / Ludmill Stankov, E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, София, 2016, f. 173-174.

<sup>39</sup> Dh. S. Shuteriqi, *Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica. Studim dhe tekste*, SF, 1965, 2, f. 112.

*Po ishtë përë vjezorë.”*  
*“Mëmo-lo, mëmo bukorë,*  
*të sëritëshsh timenë trim Vasillaqnë,*  
*të më bëjë, mëmo, ni argjentë sindjuk,*  
*pa t'më lishoj, mëmo, dë Merixhí,*  
*pa t'më zejnjë kaikçintë,*  
*pa t'më shpëtojnë nga heqimetë.”*  
*Pa ashtu bënë.*

Recitoi dhe këndoi S. Tabakçieva.

3. Nga faqja 218 në 230 jepen të përkthyer në bullgarishte përralla (Zëndërit masalla, Maros Masalla, Drakos Masalla, Maraflos Masalla)

4. Në vijim jepen të dhëna për personat që kanë treguar këngët, përrallat etj., duke përkthyer informacionin që sjell Shuteriqi.

5. Janë përkthyer dhe dy gjëegjëza (nga tri që ka punimi i Dh. Shuteriqit, *Fshati shqiptar i Bullgarisë, Mandrica. Studim dhe tekste*).

6. Por, siç kemi pohuar disa herë, punimi nuk është thjesht përkthimi i lëndës së botuar në “Studime filologjike” nga profesorët M. Domi dhe Dh. Shuteriqi.

6.1. L. Stankov ka futur në punimin *Албанският говор в село Мандрица / E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, lëndë edhe nga botime të tjera për të folmen e fshatit Mandricë. Kështu, nga libri “4 shekuj të pagjunjzuar, Shqiptarët e Mandricës”, i studiuësve Alush Kamberi dhe Muharrem Idrizi<sup>40</sup>, ka sjellë lëndën e mëposhtme:

6.1.a. Një anekdotë:

*Në Mandricë një djalë u martuevka me një shklinë nga Ortakjoj (Ivajllovgradi i sotëm). Nusja nuk ka ditur të zallahit shqipçe. Baboja (vjehrra) zen të këndojë:*

*Nuse, nuse, djallë të marrë, zjarri të djegë, se më ndoze shtëpinë. Ndërkaq nusja ia kthen: “Këndo, babo, këndo, shumë bukur këngë këndosh...”*

*(Shënim: nusja ka ditur shqip, por kënga i është dukur e bukur!)*

6.1.b. 15 fjalë të urta, si: *A n'hapesh varr, ndë varr biesh. Mënt kur janë të shkurtra, këmbët heqnë. Dë çupës derë, tropitnë ate (kuaj), tropitnë dhe gomarë.*

6.1.c. 7 mallkime, si: *Perëndia të të vrasë! Ulku kryet të të hajë! Hair mos kohësh!*

6.1.d. 9 urime, si: *Tashi dasmë, pas ni mot të keni këzanë (fëmijë)! Ecni me shëndet, bukra udhë të keni!*

<sup>40</sup> A. Kamberi, M. Idrizi, *4 shekuj të pagjunjzuar, Shqiptarët e Mandricës*, Konica 95, Tetovë, 1997.

6.2. Gjithashtu, në punim kanë zënë vend dhe rreth 50 shembuj nga ligjërimi i përditshëm në Fshatin Mandricë, të qëmtuara nga një fjalor bisedor të botuar në vitin 2015 nga Maria Peeva (Мария Пеева)<sup>41</sup>. Çdo përdorim është dhënë në tri komponente: në përkthimin në bullgarishte, në paraqitjen e thënies shqipe me alfabet cirilik (bullgar) dhe në thënien shqip me alfabetin e shqipes.

*В селото има много пътица. Пътицата са добри.*

*Дъ фиату ка шум узъра. Узърат янь мира.*

*Dë fshati ka shumë uzura (rrugë). Uzërta janë mira*

V. Një vend të veçantë, prej 67 faqesh (247-313) në punimin *Албанският говор в село Мандрица / E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, zë **Fjalori** (Албанският говор в Мандрица – Речник). Edhe këtu është pasqyruar i gjithë fjalësi që ka zënë vend në artikullin *Fjalorth i të folmes shqipe të fshatit Mandricë (Bullgari)*, të Dh. Shuteriqit<sup>42</sup>, por lënda është më e gjerë. Aty përfshihen fjalë dhe nga vepra “4 shekuj të pagjunjzuar, Shqiptarët e Mandricës”, i studiuësve Alush Kamberi dhe Muharrem Idrizi<sup>43</sup>. Fjalët e marra prej tij janë markuar me shenjën + (plus). Gjithashtu, në pjesën hyrëse të kësaj pjese jepen dhe shpjegime për përdorimin e fjalorit, sidomos për teknikat leksikografike për paraqitjen e një zëri leksikografik në shqipe, duke u mëshuar nyjave shquese në gjininë mashkullore e femërore; dhënie në kllapa të formës librore për të bërë të kuptueshme e të përqasur fjalën / formën e fjalës me formën e sotme; si dhe janë dhënë të gjitha shkurtimet në bullgarishte, që lidhen me origjinën / burimin / përkatësinë gjuhësore të një fjale të dhënë (si: англ. / angl. – anglishte, ие. / ie, indoevropianishte etj.), apo me veprën e konsultuar (БЕР – Български етимологичен речник) etj. Vend kanë zënë dhe shenjat diakritike që japin informacion për paraqitjen e dukurive fonetike dialektore (si: **ā** – a e gjatë; **a** – a hundore etj.)

Fjalori ka vlera të shumta, ndër të cilat veçojmë: fjala në shqipe është dhënë me barasvlerësin në bullgarishte; për fjalën është dhënë përgjithësisht edhe informacion për përkatësinë burimore (nga cila gjuhë e ka origjinën)<sup>44</sup>;

<sup>41</sup> М. Х. Пеева, Българско-албански разговорник с малък речник, “Фабер”, Велико Търново, 2015.

<sup>42</sup> Dh. S. Shuteriqi, *Fjalorth i të folmes shqipe të fshatit Mandricë (Bullgari)*, SF, 1965, 2.

<sup>43</sup> A. Kamberi, M. Idrizi, *4 shekuj të pagjunjzuar, Shqiptarët e Mandricës*, Konica 95, Tetovë, 1997.

<sup>44</sup> Dh. S. Shuteriqi, në artikullin e cituar, *Fjalorth i të folmes shqipe të fshatit Mandricë (Bullgari)*, në pjesën hyrëse të fjalorthit bën grupime edhe sipas përkatësisë burimore. Ai shkruan se në këtë të folme mund të dallojmë: “Fjalë dhe trajta tipike shqipe të së folmes së Mandricës: Anë (fund), anames, atyrme, avgjitkë, baltë (dhë),

shpesh fjala është dhënë në jetën e saj në thënie; në disa raste, kur për një fjalë ka paqartësi semantike, janë dhënë edhe sinonime të saj ose forma përfaqësuese në shqipen bashkëkohore; fjalësi i fjalorthit, krahasuar në rrafshin e makrostrukturor me atë të Dh. Shuteriqit, është rritur ndjeshëm, duke u shtuar numri i fjalëve në çdo shkronjë (te shkronja **d** f.v., Dh. Shuteriqi ka dhënë 43 fjalë, L. Stankov ka dhënë 71; te shkronja **z**, Shuteriqi ka dhënë 23 fjalë, Stankovi 32), gjithashtu janë plotësuar me njësi leksikore shkronjat që mungojnë te ky autor (fjalë që fillojnë me shkronjën **ë**).

Kështu, po veçojmë fjalën **prongjiz/e**,-ja (hekuri që hap pëlhurën në avlëmend, që të mos mblidhet; cimar; shul). Autori Stankov në rreth 6 faqe

bardikë, bati, blarin (blegërin), botë (gjindje), cingë, cëngërin, cjinor apo cërin, çime, çoç, dalëtë moti (të), dilgon, djellë-a, fëmilë (familje), gërmis, gërqin'je, gëzitem, gjë (gjë), gjigjem, ima (ëma), jes, ka (nga), o të kaj (do të ketë), kalsërë, karkanxolle, kërshtejkë, kllëç, kokove, kren (krej, nxjerr), llara (rralla), llotëron, mbrej, mbret (edhe për shtet), mbretëri, mih, ndanë (pranë), ni (një), njohësh (të) (të kuptosh), pagëzon, panerkë (shportë), përze, praptan, qutet, rahorë (ndeshje, luftë), shej, shklerisht, shklirë, shkla, shkopcitem, shprihem, shtillet (mbështillet, vishet), shtret, shtrofkë, tar (ar), tate, trim (djallë), tëpërton (depërton), vlon (fejoj), xallahin ose zallahin, xëngërmarratë, zbjer ose xbjer (humb harroj), etj.

**Turqizma:** Arkadashe, arnauete, Amautllëk, asqer, asqerllëk, bair, bakshish, ballkan, be (bej), belik, bendis, bitis, bostan, budallâ, bunar, bylyk, çarshi, çorbaxhi, dejman, demek, derman, divan, djyljym, dushman, duva, dyqan, ferman, gjemixhi, gjesdis, gjoks, gjol, gjuz, hakë, halë (hallë), hambar, hanë, haznatar, hellall, heqim, herbab, hiç, insan, iliaz, jordashllar, kabil, kadënë, kahër, kaik, kaikçi, kasapllëk, kavak, këzan, kollaj, komshi, konak, kurbet, kurdis, kuvet, lufe (ylefe), masallë, memlym, Merixhî, merxhan, mëhallë, muharebe, mukadër, parâ, pasha, qepengje, saba, sade, sallam, sefer, sefte, selam, senet, sini, sokak, sollak, surat, shëlmek, shimshir, temis, testembel, tjtjyjni, ujdîs, velaet, xhanëm, xharah, zaif, zamat, etj.

**Bullgarizma e përgjithësisht sillavizma:** Ale, allahticë, banellë, barabunkë, barkanicë, bash, branë, bublluk, civik, çlenove, dânak, dërzhava, dostafçik, dovolen, drankë, dugan, dune, dupkë, dushit, duvar ose dvor, erâ, gârvan, gatankë, gollopar, gëbë, hojnë, jagodë, juves, kainço, kaltjankë, kallpakçe, kaskandis, kavall, këlivaç, klepkë, korlajkë; kratunë, lefe, legallo, leshnik, luljak, llajçukë, llapcinkë, maher, mallaçke, maslin, menit, muhlas, nai, ne, nishtu, peperungë, pernicë, piskat, poprellkë, pobit, potpis, prushkufallë, puduvit, pulpit, rapkë, rasboj, sankë, sëmë, sdrednoci, semesë, sjankë, sivë, smëtin, snuvalkë, teqezesë, trudov den, uçe, udopstâ, uduvicë, veçe ose veqe, vëmicë, vi, vojskaja, zagaçit, zakon (ligjë), zavit, zhalit, zhellvë, zhitel, etj.

**Greqizma:** Anastis, ekshigjis, filladhe, gjozmë, mavrutë, pallamide, pangar, papo, papazia, prëftas, rigon, sinor, skulo, sos, shtefanos, trandafil, etj.” Shih për këtë Dh. S. Shuteriqi, *Fjalorth i të folmes shqipe të fshatit Mandricë (Bullgari)*, SF, 1965, 2, f. 153-54.

(në formatin e një zëri / të një artikulli më vete), merret me etimologjinë e kësaj fjale.

10. Punimi monografik *Албанският говор в село Мандрица / E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, është në vetvete më shumë se kaq. L. Stankov e ka parë të arsyeshme të përfshijë në strukturën e tij dhe një informacion enciklopedik të veçantë, ka dhënë të përkthyer në bullgarishte jetëshkrimet e përmbledhura / sintetike të dy studiuesve shqiptarë, që janë marrë me të folmen e Mandricës: të akademikëve Dhimitër Shuteriqi dhe Mahir Domi. Ai ka përkthyer dhe një letër falënderimi të Mynavere Shuteriqit (bashkëshortes së Dhimitër Shuteriqit) për autorin e punimit, L. Stankov, për punën e bërë me rastin e 100-vjetorit të lindjes së akademikëve M. Domi e Dh. Shuteriqi. Letra veç vlerësimeve e falënderimeve ka dhe një citim të plotë nga letra që Dh. Shuteriqi i ka dërguar Mynaveres në 28 shtator 1959 nga Sofja, ku i bënte me dije për punën e bërë. Por në letrën e M. Shuteriqit për L. Stankov ka një pasaktësi. Aty M. Shuteriqi thotë se “siç mund ta dini, në vitin 1965, në nr. 2 të revistës “Studime historike” Shuteriqi botoi studimin “Fjalorth i të folmes shqipe të Mandricës”, por studimi është botuar në revistën “Studime filologjike”, 2, 1965 dhe jo në revistën “Studime historike”. Në përkthimin në bullgarisht të letrës Stankov ka bërë korrigjimin e nevojshëm.

Si përfundim, punimi monografik, *Албанският говор в село Мандрица / E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, i përgatitur nga studiuesi L. Stankov, u jep frymëmarrje të re punimeve të Domit e Shuteriqit, duke mos mbetur rob i lëndës së sjellë prej tyre, por referohet dhe sjell lëndë edhe nga studime të tjera dialektologjike në shqipe të bëra nga J. Gjinari, E. Lafe etj. Stankov e ka zgjeruar shumë lëndën me ilustrime si dhe ka nxjerrë sytha të veçantë, duke spikatur në organizmin sistemor të lëndës së përkthyer (artikujve të Domit e Shuteriqit), si zgjedhimet pësore-vetvetore të foljeve për çdo mënyrë, formimin e pjesores së foljeve, formimin e emrave prejpjesorë etj.

Megjithatë, punimit nuk i ka shpëtuar ndonjë mangësi, që lidhet së shumti, me vështirësitë që burojnë edhe nga shkalla zotërimit të shqipes. Këtu mund të veçonim:

1. Sintaksa e shqipes është tepër e pasur në të gjitha ndërtimet. Autori te kreu për sintaksën e së folmes së Mandricës ndalet vetëm te fjalitë qëllimore, shkakore dhe përcaktore. Mundësitë kanë qenë për më shumë, me synimin që të dilte nga punimi i Domit dhe Shuteriqit (*Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, SF, 1965, 2).

2. Mendoj se autori duhej të mbetej thjesht në rrafshin sinkronik të parashtrimeve dhe mos të ngatërrohej në diakroni (mbaresa -sh, e së tashmes së dëftores dhe lidhores).

3. Shumë referime të çojnë në studimet e prof. Emil Lafes etj., por këto nuk citohen dhe nuk jepen as në Bibliografinë në fund të librit.

4. Në një botim të ri, *Pasqyra e lëndës* duhet riorganizuar. Fjala vjen, *lënda folklorike* (këngët, rrëfenjat, anekdotat, gjëzat etj.), duhet të dilte si një kapitull më vete, sepse është përfshirë në kreun e *sintaksës*.

Po e mbyll këtë paraqitje të zgjeruar të punimit monografik, *Албанският говор в село Мандрица / E folmja shqipe në fshatin Mandricë*, përgatitur nga studiuesi bullgar L. Stankov me fjalët e thukëta të profesorëve Domi e Shuteriqi se “E folmja shqipe e Mandricës, me veçoritë e saj, me fenomenet e ndryshme gjuhësore e dialektore që dalin në të, sidomos me mjaft konservacione që ka, paraqit një interes të veçantë për dialektologjinë shqipe, sidomos për dialektologjinë historike, po ashtu edhe për historinë e gjuhës shqipe. Të dhënat e saj do të jenë një material me vlerë, në mënyrë të veçantë kur do të arrihet të përcaktohet me një farë sigurie koha e shpërnguljes së folësve të saj nga Shqipëria. E folmja, si çdo ishull gjuhësor, çfaq interes edhe për problemin e kontakteve të fuqishme të një gjuhe me gjuhë të tjera dhe të përfundimeve që rrjedhin prej tyre.”<sup>45</sup>

---

<sup>45</sup> M. Domi, Dh. Shuteriqi, *Një vështrim mbi të folmen shqipe të Mandricës*, SF, 1965, 2, f. 103.

